



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DECANI

Mbledhja e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VIII , mbledhja e I-rë) me dt.29.01.2026

DEÇAN

e Enjte, 29 Janar 2026

Hajdar Sutaj

Të ndëruar anëtarë e anëtare të Kuvendit të Komunës, Të ndëruar përfaqësues të OSBE-së, Zyrtarë komunal, gjithë ju të pranishëm. Ëh, kam kënaqësinë që të hap takimin e parë t'rregullt të Kuvendit të Komunës. Ashtu siç e parasheh ligji, dhe rregulloria e punës së Kuvendit, në afatin e rregullt kohor, e kemi përgatitur rendin e ditës edhe e kemi dërgu materialin. Kërkoj që, anëtarët e Kuvendit të cilët nuk i kanë hapë, ë, email-at zyrtare, t'i bojnë këtë të, zyrtari i, përkatës Z. Yll Mazrekaj. Në mënyrë që ta pranoni materialin edhe në mënyrë elektronike, po gjithsesi ne do të të përgaditim edhe në kopje fizike, që të u dërgojmë ne zyrat e subjekteve politike, të Sekretarit të Zyrave, të cilat ju i lajmëroni edhe i deklaroni. Fillimisht, ë, ju kisha lutur që, herav tjera kur hini n'sallë, n'kit pjesën këtu për anëtarë të cilët tash janë pjesë e legjislaturës të nalin edhe të, nënshkruhen, në mënyrë që ta kem evidencën e pjesëmarrësve. Po nga ajo të cilën na e shohim prej njëzet e një anëtarëve, njëzet janë prezent. Dhe në këtë mënyrë konstatojmë që, Kuvendi Komunal i Decanit e ka kurumin e mjaftushem me vazhdu me punimet e Kuvendit. Fillimisht m'lejoni që, ta lexoj rendin e punës, e pastaj ta hapi diskutimin për rendin e punës, edhe për miratimin ose jo miratimin e tij. Pika e parë është shqyrtimi edhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhja inagruuese e Kuvendit. Pika e dytë është themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financë. Pika treta është themelimi i Komitetit për Komunitete. Pika katër, Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2026 Pika pesë, Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2025. Pika gjashtë është shqyrtimi i raportit financiar për vitin dy mijë e njëzet e pesë. Pika shtatë është shqyrtimi i raportit të planit të integritetit për vitin dy mijë e njëzet e pesë. Pika tetë është marrja e vendimit për hartimin e draft rregullores për përcaktimin e kushteve teknike, për lokale afariste ne territorin e komunës së Deqanit dhe formimi i komisionit për hartimin e kësaj draft rregullore, të ndryshme, kemi dy propozime të cilat, pastaj unë po i thomë, po pastaj ju me votë vendosni për me qenë pjesë e rendit ditës ose jo. Kemi një propozim nga Drejtoria e Arsimit, të cilat kërkojnë votimin e Komisionit, i cili, i zhvillon procedurat për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave. Meqenëse Ligji ka ndryshuar edhe përpara ne kemi votu ni komision, i cili ka pas mandat për ton vitin, ndërsa tani, për çdo procedurë duhet ketë ni komision te cili e zgjedh Kuvendi Komunal. Edhe, pika tjetër, të të ndryshmet të cilin e propozoj dhe prapë si prapë e tham që mbetet Kuvendit me, e fusë si pikë rendi i dities është, jo është edhe zgjidhja e Komisionit te aksionerëve të ndërmarrjes Hixhiena. E hapi diskutimin për rendin e ditës. Nëse ka dikush diçka më shtu, ose me thanë lidhur me rendin e diq. Po, Vatan Istrefi nga radhet e LDK-s. Ju lutem, regjia.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën, kryesus. Përshëndetje për gjithë. I nderuar Kryetar! Kryesus, ju anëtarë të Kuvendit Komunal! Po ashtu ju anëtarët e Kuvendit Komunal që jeni zgjedhur tani për mandatin e parë. Kryesus, unë kam një propozim për rendin e ditës, të bëjmë një ndryshim. Këtë propozim e kam, e kam shfaqur edhe në mandatin e kalum. Ka të beje saktësisht pikën e fundit, pikën e ndryshmeve. Kërkoj që kjo pikë të dalë e parë në rendin e ditës, në këtë legjislaturë pra. Pasi që duke e parë shumë të nevojshme këtë pjesë, pasi që këtu janë pyet, kryesore të Asamblistë, pyetje personale apo kërkesa që i kanë nga lokalitetet. Dhe shpesh herë kryetari ndoshta ka qenë i zënë edhe me aktivitete të tij gjatë punës apo diçka të ndryshme, dhe s'ka mujt të të qëndroj deri në pikën e fundit, pra te pika e ndryshme. Për këtë arsye edhe pasi që është interesimi më i madh dhe kryetari mund të jetë në mengjes këtu, kërkoj që ky propozim imi del në votim, pra pika e fundit e rendit të ditës, pra pikat e ndryshmeve të del si pikë e parë e rendit të ditës. Për shkak, për shkak të transparencës më të madhe, edhe tek kërkesave që i bëjnë Asambleista të nderuar këtu. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit edhe juve. Dikush tjetër? Atëherë ne, eh, mblidhja je po, i nderuari Syle Balaj nga LDK

Sylë Balaj

Ateher, përshëndetje për të gjithë! Tek pikat te te ndryshmev kisha pasur që ta shtim te rendit, pikë rendit të ditës edhe formimin e Komisionit për Mergatë. Eh. Ta formojmë komisionin mergatë që po dihet edhe qasja tyne fuqia gjatë fushatës edhe... kërkesat e tyne janë shumta... te formohet ai komision. Pastaj, tek të ndryshmet do ta... shtjellojmë ma gjatë.

Hajdar Sutaj

Falënderoj shumë, koleg, po n'kit raste duhet të jetë ma i elaborum.

Sylë Balaj

Po elaboroj të gjitha ndryshimet që e kam. Duhet të elaborojmë.

Hajdar Sutaj

Ë, atëherë ne, ëh, duhet me e pas një material i cili dorëzohet, paraprakisht tek anëtar të kuvendit. Po gjithsesi na nuk jemi kunder ketij propozimi, a po kupton. Na mundemi edhe tek te ndryshmet, ëh, na diskutojmë pika kaniher edhe deklarime jasht rendit dities, që me ja elaboru ti edhe, m-m-në ne seancen e ardhshme me u pajis me materia dhe me e diskutu por gjithsesi se unë e pyes Kuvendin.. A ka dikush të diqka tjetër? Po Ndriqim Qekaj nga LDK-ja.

Ndriqim Qekaj

Ju pershendes gjithve. Atëherë kam një propozim të cilin do ta përmend tek te ndryshmet, por që lidhet me pikën që kini propozuar ju. Pra, tek themelimin e Komisionit të Aksionarëve. Është një theme të cilin kam dashur ta përmend, por meqë e keni cekur, atëherë mund të bëjmë pjesë të diskutimit në këtë pikë.

Hajdar Sutaj

Okej, faleminderit shumë. Kolegët, meqenëse nuk ka deklarua më tej, fillimisht ju pyes për randin e ditës, të cilën e prezantova. Pastaj duhet t'ju pyes për ndryshimin që e propozoi Vatani për këto pika. Veç veç kush është për randin e ditës, të cilën e prezantova? A ka kundër? A ka abstenim? A tani konstatoj që me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi i miratuan rendin e ditës, të cilën unë e prezantova. Tash ju pyes për ndryshimin rënditjes. Që pika Të ndryshmet të diskutohet i bjen jo si pike e parë, sepse zakonisht pika e parë është pika e procesverbalit si pike dytë. Kush asht për? Falemnderit, kush është kundër? Faleminderit shumë. A ka abstenim? Konstatoj që me 6 vota ishin për, 12 vota ishin kundër dhe nuk kalon si, si, si propozim. Kolegë Syle, a don me qit në votim, apo don me e prezantu ti në fund? Se me e pastaj në këtë seancen e ardhshme shume me diskutu. A do me qit si propozim?

Hajdar Sutaj

Po po si propozim, pastaj po do ta elaboroj.

Hajdar Sutaj

Po, po mundem. Asnjëherë unë jam për me ta dëgju mendimin edhe propozimin ty në fund edhe nuk e kishim qitur po e kishim lon veç si të ndryshmet. Me jap ty idejen edhe mas anej me I jap rrugë kesaj pune. Jemi ok. Falemnderit shumë. Shumë faleminderit. Fillimisht, para se me e shqyrtua, domethënë pikën e parë rregullorja për punë të Kuvendit, të cilën unë e kam kërku që mu pajisë anëtarët e Kuvendit edhe me Statutin e komunës së dhe Ligji për Veteqeverisje Lokale. Në mandatin e kalumna kemi hartu ni rregullore e Punsë Kuvendit. Neni 2 pika j. thotë që subjektet politike, të cilat grupe parlamentare janë ato që kanë dy e ma shumë anëtar. Në këtë rast grupe parlamentare ka grupi AAK-S edhe LDK-se. Ju kisha lutur që mi deklarë emnat e shefëve të grupeve. Prej AAK-ja. Rifat Stokaj fjalën që me e tregua. kush është shefi i grupit parlamentar të AAKS.

Rifat Stokaj

Faleminderit, kryesus! Përshëndete përgjithë! Ne emër të Aleances, nga kjo seancë si shef grupi do të flas Zoteriu Florim Mataj. Falemnderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Grupi i LDK-së. Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Po kryesus. Atëher grupi parlamentare I Lidhjes Demokratike të Kosovës ne këtë seance propozon për shef të grupi znj. Hyrije Dobrunaj.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Atëherë këta veq deklarohen nuk votohen, sepse janë deklarimet të subjekteve politike. Faleminderit. E hap diskutimin për pikën e parë. Shqyrtimi dhe miratimi i proces-verbalit nga mbledha inaguruese e Kuvendit. Meqenëse nuk është e nevojshme ne baze te deklarimet të grupeve, nëse najkush ka diqka ne lidhje me proces verbalin e mbledhjes së kalume, i kisha lutur që me i jepë mendimin juv.

Hajdar Sutaj

Ok. Konstatoj që e kemi miratuar procesverbalin e mbledhjes së kaluara. Jemi te pika dy: Themelimi i Komitetit për Politikë e Financa. Grupet e cilat janë të perfaqesume në Kuvend kanë drejtë të i bojnë propozimet. Në

ketë rast, grupe parlamentare kemi dy. AAK-n edhe LDK-n. Mmm, meqenëse propozohen prej gjashtë anëtarëve, katër i takojnë grupit prej dymbëdhjetë anëtarëve, ndërsa të dy prej grupit prej gjashtë anëtarëve. Grupi i AAK-s shef i grupit Florim Mata urdhno fjalën.

Florim Mataj

Për anëtar komisionit për politikë financa propozoj Armend Gjoshaj, Elemedina Sadikaj dhe Rrezarta Haderxhonaj, dhe Florim Mataj.

Hajdar Sutaj

Prej grupit të LDK-së, E ka fjalën Ndriqim Çekaj.

Ndriqim Çekaj

Atëherë sa i përket Përbërjes së Kuvendit, emrat e anëtarëve të ngarë të LDK-së do t'i sjellim në mënyrë të shkruar një moment tjetër, nëse është i mundur.

Hajdar Sutaj

Sot është obligative mu u gjet. Po. Nese keni nevojë munem jep. U dasht 7 dite pune, Nese ka mundesi mundem edhe mrena dites mrena seances veq nese bon me u shty ky diskutim pak me vone. Jo, jo, ju lus. ju, los. Bëni konsultë edhe me to, edhe respektoni rendin e ditës. Respektoni agjendën që ke me dergue. Është obligative, sot më u gjet. 5 minuta nashta. Ok. Kështu unë po e vazhdoj pikën e dytë edhe ju masanej. Po ju kallxoj mirëkuptimin në raport me ju edhe kthehem koleg. Te themelimi i komitetit për komunitete. E kemi ni anetar prej grupit më të madh ni anetar prej grupit të dytë, ndërsa pesë tjerë janë prej Komitetit të Komuniteteve. A ma kini, e kam. Okej Kështu. Grupi I AAK-se, kon e propozon Faleminderit. Veçse e afroni mikrofonin kështu. Koleg edhe për juve që jeni këtu. E para mikrofonat ti keni afer, inqizohet për transkript. Mos i nderroni vendet sepse kështu jane te shkume. E dyta afroheni mikrofonin sepse inxhizohet edhe del transkript. Nuk ju dëgjohet fjala nuk e qet sistemi. Mundemi me pas ankesa, kon e propozon grupi AAK-se

Florim Mataj

Yllka Berishen

Hajdar Sutaj

Faleminderit, Shume, grupi I LDK-s, dmth e keni lan per sot.

00:13:58,622 --> 00:13:59,102 [speaker_4]

Haha.

Hajdar Sutaj

Faleminderit. Ja ja qetash ti do me thon. Po. E kështu. A a a? Po jeni dakort ju për me mu konsultu dy tre minuta. Mundemi me u liru na kemi shqyrtimi planit punë të kuvendet. ndash, ju presim. Qysh e keni ju propozimin? Po, Vatan Istrefi.

Vatan Istrefaj

Faleminderit, Kryesus. Për shkak të disa arsyeve shëndetsore shefja grupit nuk ka marrë pjesë. Ajo ka pas mi bo propozimet. Na e pam parasysh mi bo ni ditë tjetër ose pas seancës. Po kështu që po dakordohemi pas 5 minuta pe pim një kafe edhe jemi rregull. Nëse ka mundësi, A po doni mi jep 5 minuta pauzë. Jemi ne 10:24, 10:30 jemi ne salle. Faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Atëhere n te nderuar. Vazhdojmë me seancën. Konstatoj që ekziston kuorumi. Në bazë të asaj që po vrej, kemi dy mungesa për momentin ne sallë është zotëri Sami Cacaj edhe Hyrije Dobruni. Ndërsa anëtarët tjerë janë prezent. Ju lut dikon prej kolegëve që ta ftoni edhe kolegen Samin tani ne filluam seancën me sjellë si ishte këtu. Të pikat dytë. Kishim katër propozime nga grupi i AAK-s Florim Mataj ishte Armend Loshaj ishte Elmedina Sadikaj dhe Rrezarta Haderxhonaj. Grupi LDK-s Albesa Caca e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Pershendetje për të gjithë. Atëherë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës propozojmë Vatan Istrefaj edhe Ndriqim Qekaj. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë! Unë. Kështu dua me ju thënë tash na e votojme, po nese nese e kthen Ministria për shkak të barazisë gjinore, ju duhet për me ndryshu. Nëse jo, thënë sepse po e domethënë veç kini këto parasysh. Nese bjen mos thoni që na ke bashku. Ju duhet me di që kuota, sepse siç e dini me ligj kryesuesi është automatikisht pjesë e komitetit dhe udhëheq i Komitetit për politike e financa. nparim na tash spo ashtu, por nese kthehet dine qe duhej per me zgjidh, kush o per. A ka kunder A ka abstenim. Konstatoi që me gjashtëmet vota për, pa asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenient. Kuvendi Komunal e ka zgjedhur perberjen e Komitetit për Politikë e Financa, ndersa te Pika treta tash po vazhdojmë. Themelimi i Komitetit për Komunitete. Grupi i AAK-s pat propozim anëtarin e Kuvendit Ylka Berisha, grupi LDK-se. Vatan Istrefaj e ka fjalën - Vatan Istrefaj: atëherë ne propozojmë Albesa Cacaj.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Mlejoni që siç e keni në material të propozuar sipas ligjit nga komunitetit janë në 1. Shkelqim Berisha. Përfaqësues i Komunitetit Egjiptian nën 2. Hidajete Gulić. Përfaqësuese e Komunitetit Rom në 3. Bilanka Popović, përfaqësues i Komunitetit Serb në 4. Elda Sharrohoqi, përfaqësues i Komunitetit Boshnjak. 5. Bashkim Rukaj, i përfaqësues i Komunitetit Ashkali, E qes nvotim. A ka kundër? A ka abstinim? Ateher konstatoj që kuvendi Komunal me tetëmbëdhjetë vota për, me ni votë abstinim e ka zgjedh edhe Komitetin e Komuniteteve. Falemnderit! Jemi te pika 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026. Të nderuar kolegë, ky është vetëm një draft i planit punë. Ju keni mundësi me i jap propozimet e juve edhe poshtë edhe ekzekutivit, që kryetari mundet mi jap propozimet e veta, po edhe jashtë këtij plani punës sipas nevojë. Ne konsultim kur e bojm planin rrethin e ditës bashk me kryetarin ose me propozimin e juve hin pikat e rrethit ditës të cilat shqyrtohen. Shefi i grupit të anëtarëve të AAK-s Florim Mataj, në raport me planin e punës se ka fjalën.

Florim Mataj

Unë s'kam dicka ne emer te grupit. Nashta flasin veq e veq asambleistat. Kështu që nuk kam diçka, Une kisha thon Ok. Plani i punës Na ket plan punës edhe në të kalumen. Ndërsa shpesh herë nuk kem mujt me realize, ka ndodh për procedura ndryshme. Janë hi tema tjera. Jan shut tema, jonë ndryshu kështu që unë nashta kan te drejt edhe asambleista tjere koleg. Kshtu qe une jam OK.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shume Florim me qene se LDK-ja per momentin nuk ke ko shefin e grupit. Kush do me mar fjalën. Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj

Pershendetje edhe nje here! Siç e kom pa draftin e planit punes, përgjithsisht janë të përfshira të përfshime pikat e rëndësishme të cilat duhet të trajtohen. Por një propozim kam që të merret parasysh, të jetë si pikë e planit punës edhe shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit Kombëtar. Janë raportet periodike me 18 Mars, që duhet të vinë në Asamble dhe me 30 Shtator, kështu që është obligim ligjor që të jenë të diskutohen. E kom kërku edhe vitin e kalum. Nuk nuk ka ardh, nuk o disku. Kështu që kisha kërku që të jetë si pikë e planit të punës së Kuvendit Komunal. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Albesa! Drejtoreshë, a ka dicka në lidhje me këto? A kem obligim për me e shqyrtuar, a duhet me shti plan pune?

00:29:02,824 --> 00:29:07,244 [speaker_5]

Sistemi nuk ka detektur ze-----

Hajdar Sutaj

Ok. Falemnderit shume. A ka dikush tjetër në lidhje me planin e punës? Diçka? Qe ne votejme me qene se nuk ka te tjerat te cilet jane lajmru per diskutim propozimin te cilin e kemi paraqitur ka paraqitur sekretaria. Kush o per. Jo une ate e qes ne votim masanej Kush o per. Faleminderit. Tash sa po lajmron sekretarja e Kuvendit qe me 2 Korrik osht edhe pika tretë O shqyrtimi i raportit te auditorit te jashtem per vitin 2025 dhe plani i

veprimet për zbatimin e rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditimit. Domethënë është vec e përfshirë. Po patjetër. Albësa Cacaj e ka fjalën.

Albësa Cacaj

Mjetet paraprake por asnjë herë nuk janë shqyrtuar dhe nuk janë diskutuar. Siq e theksova edhe më parë janë raporte periudike të përcaktuara ligjrisht se cila duhen mu diskutu në brendë afatit ligjor siq e theksova edhe më parë më 18.03, pra në muajin mars edhe në muajin shtator. Kjo ishte propozimi që më kon në në vijë të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe vendosni siq e dini më së miri. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë edhe për rekomandimin. Nëse nuk ka ndodh që. Ëhë, nuk është diskutuar tërënjë, ëh, meqënëse është Plan i Punës, kërkojmë që edhe të diskutohet edhe përfilllet në kuadër të Planit të Punës. Ëh, më 12 vota për, 13 realisht, edhe të tjerat si votues, po për Planin e Punës. Kini abstenuë, atëherë, më dhembëdhjetë vota për edhe më 1 vota abstenuë, është ka kalu Planin e Punës së Kuvendit. Më fal, sekretar, 13 vota kam për. Po ka votuar edhe përfaqësia e PSD-s. Ëh, kështu, jemi të pika ëhë, pestë, është shqyrtimi i Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin dy mijë e njëzet e pestë. Ashtu siq e thotë rregulloria, të nderuamë anëtarë të Kuvendit, pas çdo fjale që mundet më e pas çdo anëtar i Kuvendit, ka të drejtë kryetari edhe ekzekutivi më e marrë fjalën për mu përgjigje. Kryetar, nuk e di nëse don më diskutu ti parin, apo më marr diskutimin dhe pastaj mu përgjigje.

00:31:48,556 --> 00:32:19,896 [speaker_7]

Faleminderit Kryesues, Përhëndetje për gjithë! Ju uroj punë të mbarë dhe mandat të suksesshëm, dhe rritje të objektivave, asamblees komunale. Në e kemi bërë subjekt të trajtimit para jush raportin e punës, vjetor të punës, për vitin dy mijë njëstë e pesë, dhe është në domënin e juaj, në autonomi e juaj që më diskutu, e krejtë nfund që më qenë e përfshirë në rreth raportin e punës për vitin dy mijë njëstë e pesë. Fjala është e juja.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Kryetarë, prej grupit të AAK-s. Shefi i grupit, Florim Matai, e ka fjalën.

Hajdar Sutaj

Shiqoni. Unë, dashta më e lon, ndoshta nëse kom diçka për më shtu,...

00:32:44,336 --> 00:32:47,356 [speaker_7]

Nuk kuptohet nga sistemi ---

00:32:47,416 --> 00:32:51,456 [speaker_5]

00:32:52,836 --> 00:33:02,976 [speaker_0]

Faleminderit shumë. LDK-ja Ndriqim Çekaj e ka fjalën. Ju lutna e dhizni mikrofonin në foltore.

Ndriqim Çekaj

Ju u përshëndes gjithë të nderuar pranishëm, ju qytetarë që po na ndiqni dhe ju tjetër pranishëm në sallë, të dashur kolegë të Kuvendit Komunal, nderuar Kryesues i Kuvendit, nderuar Kryetar i Komunës. Në këtë radhë pata në dëshirë të madhe në përshëndet edhe... Kryetarin edhe Drejtorat, po... Meqënëse nuk, s'keni bërë as në lëvizje në emrin të Kabinetit, atëherë kjo pom mbetet vetëm një dëshirë përtej korrektësisë politike. Pavaresisht kësaj anomalie politike, dua të them se kam folur shumë herë në këtë sallë me kapacitetet ndryshme, si aktivist i rinisë, aktivist i shoqërisë civile e më vonë edhe si aktivist politik e funksionar i Lidhjes Demokratike. Por të flasësh si përfaqësues i zgjedhur i qytetarëve, qenka një ndjenjë krejtësisht e veçantë. Andaj, në këtë adresim timin të parë du të falenderoj gjithë qytetarët e Deçanit që në zgjedhjet e dymbëdhjetë tetorit votuan për ofertën e LDK-së dhe në mesin e tyre edhe për mua si kandidat. Në mesin e një liste mjaft, ë, kualitative. Prandaj, besoj që besimin e marr ta realizoj më punë dhe angazhim të sinqertë. Shpresoj që secila përballje në këtë sallë të ketë qëllimin në vetvete vetëm Deçanin e qeverisur mirë. Tani disa fjalë për raportin e punës së kryetarit për vitin dy mijë e njëzet e pesë. Raporti i punës së kryetarit i quajtur i tillë në bazë të përmbajtjes ve, vëllimit të faqeve, nuk mund të quhet raport i punës së kryetarit, po një libër i dobët në cilin shkruhet gjithçka vetëm për të mbushur faqet, e ku quditrisht edhe krejtësisht pa nevojë, përshkruhen kompetencat e drejtërive, zyreve dhe sektorëve të qeverisjes. Që më shumë ngjason me tekstet shkollorë të

klasës së shtatë të edukates qytetare, ku ka disa njesi mesimore që flitet për strukturën qeveritare. Domethënë, krejtësisht jashtë qëllimit, po shkak është punuar raporti. Si anëtar i Kuvendit Komunal, kam pritur që ju si kryetar, zoti Ramosaj, të raportoni apo raportin ta hartoni në trajektore me përmbushjen e premtimeve me të cilat e keni marrë mandatin në vitin 2021, duke marrë parasysh që viti dy mijë e njëstë e pesë shënon dhe vitin e fundit të mandatit si kryetar i zgjedhur në, në atë kohë. Prandaj kam pritur që të paraqiteni më konkret, me numra më të preshem, me korrektësi e sinqeritet politik. Vetëm faqja dy flet për punën tuaj, pra për disa marrëveshjeve rekomandime ve, memorandumë, m'falni, ku për cilat, përveç që keni cekur që janë nënshkruar, nuk flitet asgjë për nivelin e zbatimit të tyre. Pra, raport i hartuar me qykje zorit, i kamufluar dhe tendencë qartë për të fshehur mospunën dhe mungesën e rezultatëve të prekshme. Organizime ceremoniale. Për më tepër, janë cekur si sukses veç shërbimet normale komunale administrative që do të kryeshin edhe nëse nuk kishe dalë në punë hiç, as ju as ekipi juaj.

Në atë raport ka dhe zmadhime të panevojshme janë cekura veç shërbimeve, të cilat nuk ipen fare për qytetarët. Bije fjala me faqen 47të Qendrave të Mjeksisë Familjare, për shembull në Isniq, thanë se funksionon tri njësi: njësia e Mjeksisë Familjare, Njësia e Shëndetit Rural dhe njësia e Laboratorit. Pra, ajo e vërteta e madhe është se aty funksionon vetëm njësia e Mjeksisë Familjare, por jo edhe Njësia e Shëndetit Rural dhe Njësia e Laboratorit. Unë po përmend vetëm këtë rast. Sigurisht ka edhe plot raste të tjera, por kjo ishte vetëm për ta ilustruar situatën. Nuk jam i habitur, sepse habitesh e zhgenjehesh aty ku ke pretshmëri. Por më habit aftësia e madhe e manipulimit dhe aftësia e madhe për të përpiluar një raport të thatë e papërmbajtje. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Dikush tjetër a ka diçka? Po përfaqësuesja PSD-s Natyra Kuçi, Po.

Natya Kuçi

Përshëndeti për gjithë! Uhm, kam kalu nëpër këto njëqind e sa faqe të Raport punës së kryetarit. Ky raport tregon më së miri që ky vit ka qenë ma shumë një vit zgjedhor edhe për kryetarin edhe për krejt Aleancën në Deçan. Shkurt, zgjedhjet nacionalen, tetor lokalen, dhjetor prap ato nacionalen. Njohen prej ketyre zgjedhjeve ka qenë edhe vet kryetari kandidat për deputet. Ky raport i punës është ni mshefje e mos punës me rreshta thatë. Dy faqe janë krejt që tregojnë pak a shumë ato që ai tregon edhe raporti financiar. Subvencionimin e klubeve aty këtu. Po në përgjithësi, uhm, mundem me thënë që ky vit ju ka dediku uhm, shërbim nga ky kryetar, nga ky Kabinet, vetëm zgjedhjeve dhe punës për aleancën. Kështu që uhm, shpresoj që ka me qenë reflektim për vitin tjetër, qysh, nuk guxon 1 vit me l shku shku edhe njëher qytetarve të Deçanit. Domethënë, nuk ka kurgjo që munen me diskutu përmbajtësish në këtë raport, përveç sa ato që kom mi thon te Raporti financiar, që janë uhm, paret të qume dam për fushatat zgjedhore të AAK-Së në Deçan, kaq. Dikush tjetër? Vatann Istrefaj, pastaj është Ardian Binakaj, pastaj Syle Balaj. Vatani.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën, kryesus! Atëherë sa i për ketë raportit të punës së kryetarit për vitin 2025 do të flas në përgjithësi, pra do jem sa ma i shkurt. Do të flas rreth premtimeve që ka patur kryetari në total, pra vetëm njëzet premtimi ka patur dhe gjithsej gjasht prej tyre nuk ka arritur as që ti fillojë apo ti nis këto premtime. Kështu që kryetar, pres që në ketë mandat, pasi që ke fituar përsëri besimin e qytetarëve, te mos na pres të njëjtë aventurë pra këtu, pasi që i ke pasë të gjashtime-gjashtë premtimeve të parrealizuara dhe të panisura. Pra, që kjo bjen, si për shembull, është pun-punësimi për të gjithë rinjtë e kualifikuar. Kryetari, atehere na trego se qfare do l thuash ketyre të rinjeve sot? Apo me mandatin e ri që ke fituar tanimë e ki edhe katër vite qeverisje?

Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Ardian Binakaj, fjalën. Regjia vazhdo me mikrofonin.

Ardian Binakaj

Përshëndetje për gjithë! I nderuar Kryesus! I nderuar Kryetar i Komunës, zotëri Ramosaj, të nderuar kolega asambleist, është ndjer i madh për mua që për herë të parë të flas ne cilësinë e-të zgjedhurit. Duke qenë që

është fjala ime e parë, nuk po mundem mos i falënderoj gjithë ata që më kanë besuar votën për t'i përfaqësuar këtu në Kuvendin Komunal. Nëse ka diçka që e pershkrum me se miri punën e juve kryetar, është që grafikën që e keni paraqitur në Raportin e Punës, faja tridhjetë e dy. Në qet grafikë krahasohen t'hyrat vetanake të vitit dy mijë e njëzet e katër me vitin dy mijë e njëzet e pesë. Një grafikë e dizajnuar ashtu që në shikim parë ta krijojnë nifër përshtypje që në Deçan ka ndodhur nifër boom i ekonomik. Gati-gati rritje për treqind për qind. Po realiteti, kryetar, është faktikisht krejt tjetër. Realiteti është brutal në thjeshtësinë e tij. Rritja, n'krahësimi viti dy mijë e njëzet e katër, dy mijë e njëzet e pesë është vetëm 443 euro, as 1 për qind. Ja shikoni grafikën e paraqitur në faqen tridhjetë e dy. Le t'ju kthehem shifrat, sepse shifrat na i zhveshin krejt thjeshtë nga emocionit dhe na paraqesin të vërtetën ashtu siç është. Në vitin dy mijë e njëzet e katër, t'hyrat vetanake kanë qënë në milion e tridhjetë e dy mijë e nandhjetë e shtatë euro, ndërsa në vitin dy mijë e njëzet e pesë, ato janë në milion e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e katerdhjetë euro. Kjo nuk është aspak rritje. Kjo faktikisht është stagnim. Kjo është deshtim, po i paketun kështu bukur. S'po mu, mu largu pi qesaj se përime ke perla krejt raportit. Njëherë nuk mujsa me besu se kur e pash po më vonë, kur i lexova shifrat, u binda që osht e tillë. Sinqerisht osht e turpshme tëndoshtë që kjo është iluzione, kur gjendja reale është me të vërtetë shqetsuese. Po të, po të ishte problemi vetëm ky, ndoshta do ta arsyetoja e do ta quaja minim një përpjekje për vetëknaqësi politike kështu. Por kryetar, më leni t'ju them hapur. Ky, ashtquajtur raport, është nder raportet më të dobëta që kam pa najherë ne jetën të. Që në faqen e parë, raporti flet për punë e Zyrës Kryetareit. Në pikën 1, organizimi i takimeve protokollare të kryetarit komunes, për tvazhdu të pika dy, e cila i evidenton takimet e pikës parë, do thotë evidentimi dhe mbi kqyrja e takimeve punësh kryetarit. Pika e tretë pothuajse kulmi i arritjeve. Pergatitja e takimit të Kryetarit me delegacionin vendor dhe ndërkombëtarët e nivelit lokal e atij qendror. Po na mungon vetëm në pikën katër, ajo është se analiza se si janë organizuar takimet dhe çfarë mësimesh kam nxjerrë nga këto. Ndoshta dikujt mund të mund të mju dok edhe qesharake, por kjo është çështje serioze. Për disa, për disa çështje n'ket raport edhe nuk mund të shkalohen. Në raport përmendet se kryetari ka nënshkruar kontratë, për ndërtim të rrugëve, mirëmbajtjen e tyre, ndërtimin e kanalizimeve e shumë projekte tjera. Por pyetja legjitime që duhet shtruar është kjo: sa nga këto punë janë krye realisht? Cilat projekte janë përfunduar? Cilat janë në proces? Në cilën fazë është secili projekt? Sa mjetet kem pagu? Sa obligime financiare ka ende komuna ndaj operatorëve ekonomik? Asnjëherë nga këto nuk figuron në raport. Pra paraqitet si punë diçka që nuk dihet nëse është kryer e ka ndodhur me të. Kjo nuk është transparencë. Kjo është përpjekje për manipulim. Edhe pse mbetet vetëm përpjekje, mënyra e operimit është thellësisht shqetsuese. Në raport përmendet gjithashtu edhe ndarja e mjeteve për organizata jo qeveritare. Mirë shumë deri këtu. Amë kryetar që kjo besoj që nuk është pika që ti duhesh mu krenu me to. Sepse shumica e këtyre veçeve janë të lidhura drejtpërdrejt me familjen tënde politike. Ju keni dhënë parë njerëzve të shtëpisë. Kaq e thjeshtë është kjo punë. Dhe për këtë, kryetar duhesh me dhënë përgjegjësi. Kryetar që ky raport nuk është i dobt. Ky raport është, është, është edhe me ta thy inteligjencën. Sepse kur stagnimin e paraqitni si rritje, kur protokollin e shitni si punë, atëherë nuk po qeverisni, po manipulojmë. Ky, nuk është raport punë. Ky është një raport i propagandës. Problemi më i madh është thu, mungesa e rezultatëve. Po tentoni ta shndrroni në sukses në letër. Në fund të fundit, qytetarët e Deqanit nuk ka nevojë për grafika mashtruese.

Hajdar Sutaj

Ë, nderum. Po, po, po. Ë, kështu, sepse është e planifikune edhe minutazha. Jo që e nali une, e nali sistemi vet ne baze të rregullores, Leshojani edhe 1 minutë.

Ardian Binakaj

Po e perseris edhe një herë për her të fundit, qytetarët e Deqanit kanë nevojë për punë e jo për grafika mashtruese, as për raporte që zbukurojnë realitetin. Ata kanë nevojë për punë re-reale dhe llogaridhënie e qeverisje të përgjegjshme. E nëse kjo është maksimumi që ofron qeverisia juaj, atëherë ky raport nuk është pasqyrë suksesit tuaj, por është një akt akuzë politike ndaj vetvetes.

Hajdar Sutaj

Faleminderit! Sylë Balaj, është i lajmrum për fjalë.

Sylë Balaj

Ah, atëherë përshëndetje për gjithë. Të nderuar kryesisë, të nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit. Raporti i Kryetarit është momenti kryesor i llogaridhënies institucionale. Ai duhet të pasqyrojë punë reale, jo vetëm synimet apo deklarata politike. Qytetarët e Deqanit nuk jetojnë nga raportet, por nga rezultatet konkrete në terren. Rrugët e hapura, të paasfaltume, të papërfundume, projektet e nisura vetëm në fushatë

dhe shërbimit të mangëta janë realitet që duhet adresuar me ndershmëri. Vetëm përmes një analize të sinqert mund të kurgjojmë gabimet dhe të ecim përpara. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Ë, Shkumbin Demalijaj nga PDK. Ë, zoti Demalijaj, mikrofoni tjetër dhezet, jo mfal, jo, hiq mo se prek. Veç dhezne edhe niher. Mirë, ne rregull është.

00:16:28,080 --> 00:18:22,732 [speaker_7]

Faleminderit edhe niher I nderun kryesus, përshëmdes gjithëve, përfaqësues institucional. Folen koleget, mirpo fjala e fundit e, e kolegut para praktikë ishte ajo që e permbyll edhe e ri-afirmoj edhe e rikonfirmoj edhe njëherë se me të vërtetë ky raport është drejt sikur me e papunu ni prokuror i mirë, për mi ngrit aktakuz vetvetes. Nuk di mos çka me thonë, veç me marrë edhe me pershku organigramin e punës. Gjitha institucionet komunale me i pasqyru, n'këtë formë. Me këto forma diagrame të tjera, ky, fund të fundit nuk është as raport as nuk është kurgjo, po e rikonfirmoj edhe njëherë osht vetaktakuz. Shihet se jom të bart vit pas viti edhe nënshkrimi i kontratave të vitit kalum për punët edhe shpenzimet kapitale që kanë ndodh në Komunën e Deqanit, është proces i bardhë unë vit pas viti edhe nuk di ed ra e kurgjon këtë raport shpenzime. Te zyra e Prokurimit apo te Drejtoria për Financa, ë, kush janë përfitusit, që kanë përfitu në, në, në gjitha pro projektet? Është mirë që në raportet e ardhshme mi pershku edhe përfitusit për shkak se, duhet me ditë edhe kush I ka kry këto punë që, shihet se mas shumti veprimtaria, e krejt procesi i shpenzimeve, mallrave, e shpenzimeve, shpenzime kapitale është me punë shtesë. Kaq kisha pas për me folë për këtë raport, po me të vërtetë është...Në, në një kohë bukur e gjatë jan njezet e shtat vite gati thujse që funksionon administrata komunale edhe forma e përpilimit të raportit në formën e tillë poshtë më të ardh keq. Kaq kisha.

Hajdar Sutaj

Dikush tjetër? Albesa Cacaj, LDK-ja.

Albesa Cacaj

Atëherë, të nderuar sa i përket raportit punës s'kryetarit, vazhdimisht si LDK kemi dhon kritika për tu ndryshuar qasja dhe përpilimi i një raporti te tillë. Një raport vjetor i punës s'kryetarit të komunës duhet të paraqesë qartë se çfarë është bërë gjatë gjithë vitit, sa janë përmbushur objektivat dhe si janë përdorur resurset publike. Në këtë raport sa për ta bërë më të vëllimshëm ne mungesë të projekteve të përfunduara, jane paraqitur të dhëna dhe statistika duke filluar nga organizimet protokollare, takimet e ndryshme, te kryetarit, kërkesa, memorandume, shkresa që për neve ndoshta nuk janë aq të rëndësishme sa janë të rëndësishme për tu ditur cilat projekte të cilat i ki planifikuar kryetar për vitin dy mijë e njezet e pesë janë përfunduar, cilat i ki në përfundime sipër. Duhet me, duhet me potencu faktin që jan projekte, ka projekte, janë hy në buxhet për vitin dy mi, dy mijë e njezet e pesë. Kështu që nuk po du me zgjat, thjesht po du me dit unë si këshilltare komunale po dhe qytetarët që na ndjekin. Prej këtyre dyzet e pesë projekteve, cilas janë përfundu, cilas janë n'vazhdim, duke mos harru faktin që jon projekte, ka projekte që janë përsëritura nga viti dy mijë e njezet e ni. Pastaj çështje tjetër që nuk e kuptoj pse nuk e, nuk e konstatoji në raport është zyra e ko, komuniteteve për kthim. Aty jam pjesë e komunitetit për 4 vjet dhe është dukuri që çdo vit e hasim kur dalim në terren, nëpër shkolla. Pra është pro, procesi i braktisja e procesit mësimor pse nuk konstatohet se ka braktisje e procesit mësimor. Nuk është dobësi mu konstatu është dobësi me i msheft si fakt edhe mos me marr veprime mu përmirësu situata, duke mos harru faktin se shkollimi 9 vjeçar eshte obligues në Republikën e Kosovës. Kaq fata për këtë raport. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Ëh, kështu, kryetar, meqenëse nuk ka t' tjere t' lajmrun nga anëtarët e Kuvendit për diskutim, i kisha kalu fjalën Kryetarit

Mundesisht e dhezni mikrofonin

Kryetari – Bashkrim Ramosaj

Faleminderit. Unë i dëgjova me me, me vemendje edhe me fokus i përkrah diskutimet e kolegëve te Asamblesë. Në raport i te punes është edhe raport sektorial që permblet qe vjen në zyren timen e që çdo drejtor, çdo sektor ka me pershku kompetencën e vet. Numrin e lëndëve që i ka kry, numrin e palëve që i ka prit, numrin e lëndëve që janë kry, që janë refuzu, ato që janë në pritje. Edhe po ashtu, et, premtimet e mia balancing mes asaj që e kem projektin në shkurtin e vitit, në shtatorin e vitit paraprak, për vitin e ri buxhetor. Pjesa e premtimeve po ashtu që janë premtime publike politike që unë kom marë përsipër. E normal që mundet me e pas ni çakordanç që unë jam i vetëdijshëm, për këtë pjesë. Mirëpo qës, asi herë, as sot, as nesër,

as sa te jom Në këtë funksion nuk u me hek dorë e prej pjesës së premtimve të disa projekteve që janë... Insistimi dhe objektivat që ky qytet duhet me mbërri. Dhe po ashtu, ni far bilanci mes asaj që i thojmë e buxhet, eh, qe dakordohet qysh në esencë. Buxhet që e ki si komun, buxhet që ti pretendon me josh një mekanizëm buxhetor të nivelit qendror ose një mekanizëm buxhetor të nivelit, të nivelit të ndërkombëtar, sikur ka ndodh ne Deqan, me disa projekte. Unë, kam qenë për dit ne pune edhe e di me çfarë punë jom marr, e di me çfarë punësh jon marr kolegt e mi, i punëtoret të kësaj komune. Administrata e kësaj komune jam teper krenar me ate qe kemi mbërri. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, kryetar! Atëherë ne siç e dini që raportet nuk votohen, vetëm diskutohen, meqenëse diskutimet sa i përket kësaj teme vetëm përfundun. Atëherë na jemi te pika, kalojmë te pika, e gjashtë që është shqyrtimi i raportit financiar për vitin dy mijë e njezet e pesë. Drejtoreshë, drejtoreshë aktuale për Buxhet e Financa, Dafina Cacaj e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Përsëndetje të gjithë! E nderuar Kryetar, E nderuar Kryesi, te nderuar Asamble, të nderuar Drejtor, fillimisht, lejoni t'ju uroj mandatin e ri të Asambleistav. Edhe ishalla ju shkon mbarë ky mandat. Unë... Në pikat shkurta dua të sqaroja në lidhje me raportin financiar të vitit dy mijë e njezet e pesë, dhe realizimin e buxhetit. Buxheti fillestar për vitin dy mijë e njezet e pesë, sipas votimit në Kuvendin e Komunës, pastaj edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka qenë 14,401, 936 euro. Nga të hyrat e bartura, të cilat kanë ardh. Nga viti dy mijë e njezet e tre për tu bartur në dy mijë e njezet të katërt kanë qenë 184,532.24. Gjatë vitit dy mijë e njezet të pestë, është marrë vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datën pesë, gjashtit e dy mijë e nisje të pestë, për ndarjen e mjeteve në vlerë prej 319,594.29, sipas rritjes 0.5 njesish të koeficientit edhe vendimi i fundit që u marrë me 25.12.2025 është në vlerë prej njezet e pesë mijë në kategorinë e njezet e pesë mijë euro në kategorinë e pagave në muajin dhjetor. Pra, nga këtu ndryshime del që buxheti përfundimtar për vitin dy mijë e njezet e pes ka qenë 15,083,944.91. Ndërsa është shpenzuar 15,018,096 qe l bje 99.56% Ndërsa inkasimi i te hyrave, të cilat kanë qenë të planifikuara sipas qarkores, e cila ka ardhur qarkores së parë edhe qarkores së dytë. Planifikimi për vitin dy mijë e njezet të pestë ka qenë 900,000, ndërsa inkasimi i tyre nga te hyrat tatimore dhe jotatimore ka qenë 901,779.16 ndërsa të hyrat indirekte, të cilat janë jo të planifikuara nga ne, janë të hyrat nga policia dhe gjykata, që në total janë 167,498. Pra, të hyrat totale për vitin dy mijë e njezet të pestë janë 1,069,277.16 E kemi tejkalim të planifikimit. Jemi të vetdijshem, qe u tejkalu përqindja e dëshirueshmë ose sa na kem qef te për dëshirën tonë. Na kishim marr te hyra edhe më shumë, mirëpo qyteti i Deqanit është një qytet i vogël edhe biznese te medhaja. Nuk kemi, jemi uhm, me obligime. Kaq sa na kanë qytetarët edhe bizneset, jemi munduar të inkasojmë sa ma shumë edhe. Po ashtu janë edhe shpenzimet tjera të cilat kane ndodhur gjatë vitit sipas kategorive dhe të shtjelluara secila një ka një sipas kategorive ekonomike dhe fonde burime ore, për të cilat ju mundeni me na u drejtuar mu edhe kryetarit pyetjen nëse keni diçka të paqartë, se nuk po hi në detaje për secilin veç e veç me me lexue. Unë që kaq per fillim, faleminderit shumë.

00:27:04,096 --> 00:27:20,116 [speaker_10]

Faleminderit drejtoreshë! Prej grupit të AAK-së nuk ka të lajmrum për diskutim prej grupit LDK-s. Ardian Binkaj në emër të grupit apo? Po. Atëherë ai Ardian Binakaj e ka fjalën.

00:27:21,496 --> 00:32:34,200 [speaker_5]

Sot jemi ftuar këtu për të diskutu për shume pika, ndër to është edhe kjo, raporti financiar për vitin që lamë pas. Ju thonë drejtën përveç mënyrës katastrofike e aspak profesionale të hartimit, mungesës së sqarimit shumë gjanav. Shumë dhimbshme janë edhe gjanat që ka brenda ky raport. Po ndalem fillimisht te investimet kapitale, pra te katalizatori kryesor që ndikon në rritjen e mirëqenies së qytetarëve tonë. Përveç që shuma e planifikuar për tu shpenzuar është e vogël, ju keni edhe suficit. Ju kanë tepër paratë, ta merr menje që ne Deqan eshte gjithçka në rregull. Buxheti final për investime kapitale nga granti qeveritare është dy 2,975,661. Ju e keni shpenzuar këto nga këto, 2,941,442 e katër qind e katër të dy euro. I kanë tepër plot 34,218 euro vitin e kaluar. Se sa planifikoni, nuk kam nevojë, mia u thonë unë. As kerkush tjetër këtu. Këta ia thoni vetes vetë në raport. Parmendojeni, keni planifikuar te hyrat tatimore për vitin e kaluar 537,615 ndërsa keni realizuar 395,517 Diferenca e ja keni huq për 142,000, rreth 30% në te hyrat tatimore vet komunës ku jemi. Tjetra shumë e rëndësishme, kryetar, i kishit shpenzuar rreth 200,000 euro tu pagu njerëz që kishe për shërbime këshilluese. Qysh a krejt strukturën e Aleances ne Deqan doni mi shti ne punë n'komun a? Ma e forta ke që kishin dalë në tri kategori: qita punësimi në kontrata mbi vepër. Kategoria e parë ishin shërbimet shërbime keshilldhene dhe profesionale. Këta e kishin kap 60,000 euro. Kategoria e dytë kishte shërbimet veçanta konsulent të

kontraktuar. Thujse e njëjta, veç që jetë veçanta, hapat veçantë. Këta i kishin kapur rreth 79,493 euro. E treta e ma e madhja, shërbime kontraktuese të tjera. 92,504 euro. Të gjitha këto makinacione me punësim të militanteve vlen kanë veç një shpjegim. Kryetari e ka përgatitur terrenin për zgjedhje që u mbajten në mujin tetor, pra kryetari ka nxon argat. Kryetar, me thënë drejtën qytetarët ë Deçanit, nuk ua kanë me borgj me ua zhvat buxhetin për çështje partie. Ma e renda është fakti se nuk ka kurrë far të dhëne se për sa persona behet fjalë, ku dhe çka punojnë këta. Një gjë tjetër interesante në këtë raport, ke se për vizita jasht shtetit për transport kishte deklarë 1,392 euro. Për akomodim-- akomodim 4953 eyro Deri ketu hajde ok. Po a e dini ku është anomalia ketu? 12,142. e kishit deklarë se janë shpenzuar, po të citoj shpenzimet e tjera për udhëtime zyrtare jasht vendit. Mire bre kryetar po kuptoj bileta ti ki blé, hajde më rregull. E kini pagu hotelin, ndoshta pak ma mirë se keni pasë qef si kryetar i komunës. Amo qeto shpenzimet e tjera që per kalojne edhe akomodime edhe transportin nuk po di ku jonë shku. Në marrëdhënie tjetër, në këtë buxhet është fakti se për kontrollin teknik të automjeteve i kini shpenzuar veç tre qind e nonjdhëdhë euro, që pi bëjnë rreth dhjetë njëmbëdhjetë automjete. Ama për riparimin e këtyre automjeteve e kini shpenzu rreth tridhjetë e pestë mijë euro. Shumë para, amo perimeshë shume pare kish pagu komuna e Deçanit në fakt, jo komuna po qytetaret e Deçanit, për vendime gjyqësore. Pagesat sipas vendimeve gjyqësore edhe pse paqartë si pagesa për vendime gjyqësore si vendim gjyqësor thuajse e njëjta po ishi nda në dy kategori. Mbi tremijë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë euro i keni pagu për qetë sen perjashto qitu n'qet pjecë vendimet që kan tboj me kontratat kolektive. A dini qysh shpjegohet kjo? Kjo ka veç një shpjegim. Vec se keni bo marreveshje xhentëlmenësh me operatorët ekonomik që me i qu çështjet në gjykatë, pastaj me i humb dhe në fund me përfitu ju dhe operatorët ekonomik krejt në kurriz qytetarëve. Këto kenë vetëm disa skandale që përmban ky raport famkeq. Ka edhe shumë tjera, por për shkak të kohës nuk po mundemi i përmend gjithërendë. Në fund të fundit kjo është pasqyra juaj e më e mirë qeverisjes, paftësi, keqpërdorim edhe abuzim. Prandaj, nderuar kolegë dhe qytetarë të Deçanit. Ky raport është thjesht një dokument financiar. Ky raport është një aktakuzë politike. Është dëshmi e një qeverise që s'ka ditur të planifikojë, s'ka dashur të jep llogari dhe ka zgjedhur të përdorë parën publike si mjet për interesa partiake e private. Kjo nuk është qeverisje, kjo është administrimi i buxhetit pa pikë morali ligjore. Qytetarët e Deçanit nuk e kanë votua askënd që t'ua kthej komunën në një bankomat privat. Sot ky Kuvend ka për detyrë që të mos mbyll këtë kapitull me heshtje, por me përgjegjësi, sepse heshtja është bashkëfajësi. E një të paktën nga këtu nuk duhet të jemi bashkëfajtorë ksaj paftësie të këtij keqpërdorimi dhe abuzimi me paratë e qytetarëve. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Dikush tjetër? Vathani është lajmëruar i pari. Më fal Hyrija ka qenë e lajmëruar edhe më herët. Hyri. Hyrija, Vatani, Ndriqimi, Sylja. Mdotet kogja nifaz konkurrencë mes vete. Respekt. Hahaha. Shumë mire ----

Hyri Dobrunaj

Po sa i takon kesaj qeshtje, mbi të gjithë për ça e pata fjalën. Ky raport financiar siç e dini edhe herat e kaluam nuk i plotëson ato kriteret për me e kuptu. Secili prej asambleistëve të zgjidhun pavarësisht icilit subjekti takon. Raporti përsëritet sikur katër vitet e fundit asnjë gja ska ndryshu. Këtu kemi të gjitha shpenzimet këshilluese profesionale të veçanta, shërbime kontraktuese të tjera që shkojnë ni mori mjetesh. Edhe kerkush nuk e dinë ku edhe për kon së qashtu osht i përpilum raportin me qellim që mos me u dit. Uh, kur folet pare për raportin e kryetarit e ndëgjova për projekte. S'ka projekte në komunën Deçanin e kemi thon vazhdimisht perderisa përmbarues i merr tre pikë tetëqind e pesëdhjetë milion. S'keni ku mi marr me pas projekte zhvillume deri në fund. Plus çdo kësaj që me këtë raport na nuk e dim këto mjete janë të hektë te kapitalet, atë mallrat e të shërbimeve, sepse ashtu e keni përpilu ju. Po pyetja jeme oshtë, çdo shërbim i veçantë akshilluese edhe kontraktuese tjera, a i keni shti në një kod tjetër shpenzimeve këtu apo janë bashkë të qëjtë këtu që i keni paraqit. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

E ka fjalën Vatani, Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën, kryesus. Një replikë shpejt. Qytetarët për këtë punë e kanë votuar që ne t'i përfaqësojmë në Kuvend/Asamble, kështu që edhe konkurrenca është e mirë. Sa i përket raportit financiar të kryesisë, pra dëshirojmë që të diskutojmë gjerësisht për të. Nëse doni të shihni se si është keqpërdorur paraja publike, e merrni këtë dokument edhe e lexoni. Nëse e keni kohën tani edhe ju vetë. Si për shembull, ne jemi

një shembull jo shumë i mirë si komunë, pasi që dua ta cej një shembull. Vitin e kaluar ishim në një trajnim me disa kolegë të gjitha partive, të cilët sot nuk janë pjesë e legjislaturës, edhe trajnuesit aty kishin marrë si shembull komunën e Deqanit, se si është keqpërdorur paraja publike, si për shembull kur ka bërë edhe në shkrimin e kontratave pazotimin e mjeteve. E ne për shembull kryetarin në këtë raport e shohim edhe pak a shumë keqpërdorimin e parasë publike, si për shembull në lëvizjen e tyre nëpër kode buxhetore. Kemi pasur vit. Nuk po flas vetëm për vitin dy mijë e njeat e peste, por për komplet mandatin. Kemi pasur vit, kryetar, vit kalendarik të plotë, ku ke pasur shpenzime vetëm për darka apo dreka mbi 100.000 euro. E ky është një shembull më i mirë të cilin nuk duhet as të zgjas fjalën më. Lërë më se ku kanë qenë tani nafta, telefonja mobile që ka patur fakturë ndonjëherë që kemi paguar deri në 40,000 euro. Call center me kon Deqani kryetar nuk mundesh me mbërri ti at shumë, kështu që ke kjo punë është ne hetime më të larta, po këtu po përfundoj. Falemnderit.

00:00:12,700 --> 00:00:15,560 [speaker_1]

Ndriqim Çekaj.

Ndriqim Çekaj

Falemnderit kryesues. Tash sa i përket raportit financiar, unë nuk do të përmend shumë shifra se i përmendën edhe kolegë të tjerë, po kështu si parim i përgjithshme. Të shqetëson fakti ndarja e kategorive qysh janë bërë në mënyrë shumë të paqartë. E normal që shqetësimi kryesor janë shifrat e mëdha të shpenzimeve të pa arsyetura prej shërbimeve këshilluese, shërbimeve veçanta, shërbime kontraktuese tjera, domethënë ni, ni kaos i dhënies llogarit. Për këto shpenzime. Tani mos flasim për pjesën e derivateve o vendime gjyqësore edhe mijëra euro të sistemuara tek kodi buxhetor. Mirëmbajtje rutinore që as nuk kuptohet për çka është fjala. Edhe në rastet e tjera, kur ndoshta edhe nuk është shumë e nevojshme. Tani mos flasim për këtë pjesën furnizim me ushqim dhe pije. Dhe kemi pasur një nevojë të jashtëzakonshme. Me vendos në kllapa që nuk bohet fjalë për dreka zyrtare. Tash po du edhe niher mu kthi te qekjo pjesë e shërbimeve këshilluese është sado që është tragjike kjo pjesa e shpenzimit dhe abuzimit e zhvatjes të parasë publike. Është, ka pak tvjen edhe me kesh. Kur i sheh do, do pjesë qysh I kini emertu. Për shembull të shërbimi i zjarrefikseve nuk i di çka i vyn këshilltarët aty. Ata ka mundesi që kanë nevojë për mjete, pune, për kushte, për pagesa më të larta. Po këshilltar nuk e di çka i vyn zjarrefikësve. Mandej tek zyrat e kuvendit komunal është e njëjta e njëjta çështje. Zoti Kryesues a ke bo naj ekspertizë për mënyrën e funksionimit të kuvendit. Si shembull do e marr. Kom harru mi vetë ta kolegëve të mijë a kanë pas këshilltarë, asistenti, fotografa të paguun prej komunes pat nevojë. Domethënë gjithë, gjithë këtë pjesë të shpenzimeve. Është vetëm se rast sepse në drejtorite tjera apo sektor tjer ka shuma edhe më të larta për këtë aspekt. Për shembull, njezet e dy mijë euro është të infrastruktura rrugore, domethënë shërbime këshilluese. Po më keq është fakti që me gjithë këtë nevojë për me akomodim interesa që kamuflohen si këshilltar si këshilltar. Komuna Deqanit e vazhdon me qenë e radhitun keq e më keq në të gjitha segmentet edhe raportet me të cilat përcillet puna e komunës. Për shembull, këta do duhet të paktën me ndihmuar që komuna me dal mirë në raportin e transparencës. Për shembull, këta që marrin pare për këshillim do duhej që komunën me nxjerr mirë në raportin e performancës, që me qenë njëra prej komunave që përfiton grant, të paktën e dhjeta. Ose p.sh. Tek perfaqësimi i komunës në rastet e vendimeve gjyqësore. Prandaj ky raport është veç vertet një alarm për mënyrën sesi shpenzohet paraja publike. Falemnderit.

00:03:35,500 --> 00:03:41,940 [speaker_1]

Po e nderume veq Syle Balaj eshet lajmrur per fjale perpara. Pastaj Natyra Kuqi nga PSD-ja. Urdhno Syle

00:03:42,200 --> 00:04:10,180 [speaker_3]

Atehere pershendetje edhe nje here. Raporti financiar është pasqyra më e qartë e qeverisë. Pyetja kryesore nuk është vetëm sa janë shpenzuar, por si janë shpenzuar, pse edhe me çfarë ndikimi për qytetarët. Efikasiteti financiar matet me projekte të përfunduara jo me mjete të bartura nga viti në vit. Transparenca financiare është parakusht i besimit publik dhe duhet të trajtohet si prioritet, jo si detyrim formal. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë. Përfaqësuesja e PSD-s Natyra Kuqi.

Natyra Kuqi

Do me thonë ky raport edhe njëherë na konfirmon që komuna e Deqanit osht keq menaxhu n'vazhdimsi. Prap duhet me theksu qe viti i fundit osht vit me tri pale zgjedhje edhe kto mas mirti e pasqyron ky raport financiar do me thon jemi nji t'paktat komun mos t'tham e vetmja n'Kosove që borxhet naj tejkalohen pra borxhet

përgjithësisht domethonë ato që i kini nëpër zera t'shkrum si vendimet gjyqësore. Borxhet i tejkalajn Investimet kapitale të komunës së Deçanit pra investime kapitale për 2025 I kem 3 milionë e 661 mijë. Borxhet i kem gati për 100 mijë ma te mdhaja. I kam zgjedhë këtu disa prej zerave, të cilat normalisht kam me i përcjell edhe n'e-mail te zyra e kryetarit, në mënyrë që me marrë përgjigje prej tyne, për një komunë që e ka një buxhet kaq vogël. Shërbimet këshilldhenese janë 232,350. Çfarë shërbime konsulentë ose këshilldhenese ju ka ndarë Komunës së Deçanit? Kush janë ato kompani që i kanë ofruar? Kjo ka me qenë një pyetje imja. Telefona mobil për 1 vit i kanë kushtu komunës 16,000 euro. Çka cila? A po edhe kjo pjesë e fushatës zgjedhore dhe normalisht që i ka mbuluar buxheti i komunës së Deçanit? 15 mijë janë tepër shumë për telefona për ni vit. Kompjuter pajisje tjera 82.000 euro. Çfarë kompjuter? Cilat shkolla? Kush ka marrë kompjutere apo pajisje tjera për ni vit? Që komuna i ka shtu të 82,000 apo i ka shpenzu për këto? Kemi furnizimet pastrimit 52.000 euro. Çfarë pastrime? Kush? Cila kompani ka marrë 52.000 euro? Çka janë këto furnizimet pastrimit 52.000 euro për një vit? Naftë për ngrohje qendrore 80.000 euro. Cilat shkolla ngrohen me ngrohje qendrore? Kom shku nëpër shkolla ca kom vizitu. Ndodh që e kanë ni klimë drejtorit po jo ma shumë. 78.000 euro naftë për klima, pra për ngrohje qendrore i kanë shku komunës së Deçanit, nëndërkohë që derivate per automjete edhe për gjenerator ishin 134.000. Domethën naftë 80.000 derivate prej automjete gati 140.000 dhe n'anën tjetër 100.000 euro për dru i kanë shku komunës së Deçanit 100.000 për dru gjatë vitit 2025. Krejt këto për mu janë njehten kohe pikëpyetje. Nuk kam dilemë që është keqpërdorim, po edhe kisha dasht me dit me kon ka ndodh ky keqpërdorim. Kush është i përfshirë dhe kush ka përfitu konkretisht? Kemi domethën 50.000 vetura zyrtare ne këtë raport për ni vit 50.000 euro komunës së Deçanit i kanë shku për vetura zyrtare të komunës ket vit. Domethën kanë ble vetura të reja apo çka, çka do qoftë po ni komunë kaq e vogël me kaq probleme. Sa kom pa unë kur prindërit qesin parët për me bo ni bunar në shkollë, domethën bashk qesim parën, nëndërkohë që komuna blen 50.000 euro për ket vit kalendarik veturë. Trotuarë 96.000. Normalisht kom me qu edhe ket shkresë. Me dit çfarë trotuar është kush? Cilat fshatra? Ku kokan shtru 96.000 euro trotuar? Paisje e të gjenerimit të energjisë elektrike në drejtësim publik 150.000. Edhe këtu duam e dit kush? Cilat fshatra? Kush koka furnizuar për ni vit me 150.000? Dru e thash 100.000 ushqim dhe pija jo nga zyra e kryetarit është ni zot tjetër. 32,433 për ni vit. Sigurisht edhe kjo tregon që ni komunë me ni buxhet kaq të vogël e me ni luks kaq të madh. Ketë shpenzim e shpjegon veç zgjedhjet, të cilat i janë pagu prej buxhetit qytetarëve te Deçanit tri herë radhazi. Për qeta na ka kushtu shtrejt fushata secila n'Deçan sidomos, sepse çdo mekanizëm ka qenë n funksion te Aleancës për Ardhmerine e Kosovës. Pagesat për shërbimet e varrimit i kem dikun 37.000 euro. Kush janë? Çka? Ah qysh po pagujnë shpenzimet e varrimit pi komunës së Deçanit? Kush po I zgjedhka? Mbi cilat kriterëe është mirë me pa? Nashta edhe mundemi u pajtu këtu, po duhet me ditë qysh i kanë kushtu procedu, procesi i varrimit Deçanit me 37.000 euro. Tu e ditë, tu e ditë që është kon edhe ni kontratë tjetër të cilit e kam përmien fushatë, e cila i ka kushtu komunës së Deçanit 80.000 euro për mirëmbajtjen e varrezave. Dhe unë mund të thom që as dy varreza prej 76 pika sa kanë qenë, nuk kanë qenë të mirëmbajtura. Sigurisht edhe këtu kemi çka me pa. Edhe ni her pe tham ky raport është mi fsheh keqpërdorimet. Jemi ndër komunitat e vetmet që i tejkaloi me borxhe investimet kapitale. Kisha dasht me dit këto vendime gjyqësore. Sa jon për mësim dhënës? Prej 3 miliona e 676.651 euro. Sa prej këtyne janë për kontratat e mësim dhënësve dhe sa për kontratat që janë bo nprag fushatës ad hoc nga kryetari i komunës për me ble edhe me ble vota. Na e dimë, domethënë nga raporti ato çka janë me tre. Për me ditë edhe koleget e mi asambleistë, ato që ka fillojnë me tre merren nga investimet kapitale. Pra krejt këto shpenzime vendime gjyqësore që ka fillojnë me tre merren nga investimet kapitale. Pra komunës së Deçanit investimet kapitale i merren për vendime gjyqësore nga, nga investimet kapitale. Diçka që e tregon për ni keq menaxhim të madh të buxhetit Deçanit. Subvencione për entitete publike 146.000. Kush janë kriteret mbi të cilat bazë janë dhënë këto subvencione? Apo edhe kësaj here jon ble votat përmes subvencioneve? Transfere sociale për individ janë gati 70.000 68.000. Kush janë këto transfere sociale? Për cilet individ i kanë kushtu komunës së Deçanit për ni vit transfere sociale 68.000 euro. Ndërtesa administrative 150.000. Ç'ka osht ky zë? Ç'ka shpjegon 150.000 euro ndërtesa administrative? Dhe objekte kulturore sportive.

Hajdar Sutaj

Po nderume. Eee nese ki mundësi edhe pak sekonda veç me e përfunduar.

Natyra Kuçi

Jom në përfundim. Objekte kulturore sportive i kanë kum, kushtu komunës së Deçanit 412.156. A keni pa ndonjë objekt sportiv të rënovum, të rregullum gjatë vitit 2025 komunën e Deçanit? Nese e marrim veç parkun qendror edhe e shohim që a gjen jashtë, tregon që ky 412.000 nuk është i shpenzum për objekte kulturore sportive. Gjithsesi une e lo t'hapun që n'këto email-a mu përgjigj kryetari me dokumente konkrete ku kanë shku, si kanë shku, ku i ju kanë dhon. Përndryshe, nëse nuk marr përgjigje, kom m'i qu te Ministria e Financave

qysh e boj zakonisht dhe Agjencia për Privaci. Agjencia për Privaci mas fundit ju ka dënu me katër mijë euro se s'mu keni përgjigj në asnjë anë prej kërkesave që i kam bo. Unë kom me vazhdu me i bo kërkesat për këto. Besoj që është në mirën e qytetarëve të Deçanit me ditë qysh janë kamuflu këto zëra edhe qysh ky buxhet i vitit 2025 u kon ma shumë buxhet për me ia u pagu fushatat juve që keni hi krejt nëpër lista të deputetëve prej, Zeq Malaj deri te secili, në mënyrë që mi përdorë assetet e komunës, mi përdorë mësimdhënës, mi përdorë shkollat si infrastrukturë dhe parë e të komunës për me pagu fushatën, ah, zgjedhore të Aleancës. Pres përgjigjen në ato emaila. Nëse jo, pres nga Agjensioni për Privatësi. Me ju denu dhe i marr përgjigje nga Ministria e Financave. Faleminderit shumë!

Hajdar Sutaj

Ëhë, ëm falni është, ëhë, për fjalë zotëri Shkumbin Demalijaj. Ëh, ëm falni, ëm falni, ëm falni, ëm falni Ju lus, Ju lus, Ju lus. Ëm falni. E ki ardh, e ki ardh, m'falni. Julius me edhe pjesmarës të tjerë që janë me u rezervu pjesmarës tjerë kanë drejt me marrë fjalën nëse kryesues ju jap fjalën. Po Ju lus që mbrapa rregullores me me me pas. Besoj që ke mirëkuptim në gjithë veç zotëri Demalija, urdhno.

Shumbin Demalijaj

Ëh, faleminderit edhe njëherë, kryesus! Na raportin financiar që e kemi përpara vetes e kemi trajtu gjatë vitit kalum vazhdimisht në fushatat zgjedhore edhe ka shumë ndryshime mes tremujorit të parë edhe gjashtë mujor të dytë vitit kalum. Do të thotë nuk jom ne të barazuar me shifrat e shpenzimeve në raportit që janë dalë para prapakisht në Asamblenë e kalum, po unë pe trajtoj këta se kemi pas ni fushatë zgjedhore edhe dihen shpenzimet se si kanë ndodh. Për mos mu lshu veç e veç nëpër pikat, se s'dije edhe a mundem me marrë përgjigje këtu, për shkak se edhe mundësia e-e-e marrjes fjalës për secilin rast veç e veç është e-e kufizume. Mirë po bashë m'u intereso diçka që m'u lidh qetash me më ndërhyrje në e pjesmarësve seance që nuk janë të zgjedhur. Sindikatat. Po flas për pikën gjashtë të Raportit shpenzimeve për periudha janar dhjetor dy mijë s-sipas fondit burimor dhe kodeve ekonomike. A ka sindikat t'pavarun në Deçan? Kush e drejton ata edhe a osht krejtishtë e pavarur a po janë njerëz politik që i prinë edhe është një raport i shpenzimeve 17,240.78 euro. S'kemi parë ndonjë aktivitet sindikal shumë të veçantë edhe mbrojtje të drejtave të punëtorëve, përkundrazi e dimë se si punëtorët janë përbuzur, janë larguar, janë sharë edhe janë nxjerrë prej pune, duke filluar prej kryetarit të shkuar. Kështu që për këtë raport, këtë pjesën tjetër të raportit besoj se në të ardhmen e afërt do të ketë ndërhyrje edhe nga mekanizmat e mbrojtjes ligjore, sepse e dimë çfarë ka ndodhur këtu. Vetëm shpenzimet për zyrë i shohim dikund sot. Një trajtim ndryshe — se në raportin financiar tremujor të parë, prilli i vitit të kaluar, kanë qenë dikund nja shtatë e dy-tre mijë euro, vetëm në tremujorin e parë që janë bërë shpenzime furnizime për zyrë. Tash dallon ajo, duhet trajtuar edhe më shumë. Bashkë me këtë, do të kisha interes unë që mundet të më japë dikush një përgjigje për — organizimin sindikal — ku i ka harxhuar ato shtatëmbëdhjetë mijë e treqind. Nëse dikush mundet të më japë. Po ndalem këtu, për shkak se ky raport i poshtëm është vetëm për t'u kaluar lehtësisht, për t'u trajtuar, sepse ka filluar viti i ri buxhetor dhe pse Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka aprovuar buxhetin për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Do të shohim atje se si do të kalkulojnë, do të barten këto kontrata edhe këto shpenzime për këtë vit. Për qytetarin s'kemi çfarë të flasim — ai nuk ka asnjë dobi. Çfarë ndodh në komunën e Deçanit — ka pasur mundësinë me trajtuar me votë më dymbëdhjetë tetor ndryshimin e madh që e ka pasur. Ka vendosur që të jetë edhe një herë kjo strukturë që duhet ta drejtojë komunën e Deçanit. Vota është ajo që e ka vendosur mirë, po ky është një trajtim i fundit i asaj çfarë është terrori i financave të komunës së Deçanit — çfarë ka bërë kjo udhëheqje. Faleminderit.

00:16:43,074 --> 00:17:20,804 [speaker_1]

Ëhë, zotëri Faton Selmanaj e ka fjalën. M'lemoni kolegj t'ju tham se, ëh, perfaqësuesi i Kosova pressit po m'trgon se po ka ndërprerjen pi nalet sinjali po i videot qiten ne YouTube. Domethënie ingjizimi i plotë, ëh, qitet në YouTube edhe po shpresoj që, ëh, domethënë e postoni meniher. Faleminderit shumë. Faton Selmanaj e ka fjalën. Ëh, problemet që i kanë këta në bazo, jo ne, se këtu kem rryme po

Faton Selmanaj

Faleminderit, kryesues! Përshëndetje të gjithë! Unë për këtë buxhet, për këtë shpenzim buxhetor kam folur edhe në raportime periodike kështu. Nuk dua të zgjatem shumë, me faktin që u ndërpre transmetimi. Edhe dua t'i bëj me dije kolegëve të ri, të cilët kanë fjalë të rëndësishme me thënë për çfarëdo teme, paraprakisht per ligjerime. Sepse transmetimet saher qe ka tema të rëndësishme. Ndalojnë saher qe ka votime buxhetore. Psh, vjetore, ndalohet sarë që ka raportime. ndalohen.

Kur u diskutua edhe votua plani zhvillimor komunal po ashtu është ndalu edhe mu sot në transmetues më brigën me raportu edhe në Kosova Press, sepse ka një bashkëpunim me juve, sepse këta e bën me urdhra. E po ashtu edhe në Komisionin e Pavarur për Media, për arsyet që. Nuk keni kontratë me një subjekt politik, po keni me një institucion. E respektivisht do ju duhet të mi përmbahet asaj kontrate. Pra nuk është hera e parë që transmetimi ndalon, po sa herë që ka tema të rëndësishme transmetime në Kuvendin e komunës sonë ndalojnë.

Hajdar Suta

Eshtë. Eshtë. Eshtë I nderum. Kështu osht tu i ngjizu në kanal. YouTube dalin krejt mbledhjet komplet edhe mundesh me hi me i kqyr edhe tjetra Kisha inkuraju me shume respekt qe me te vertet me verifiku edhe me e vërtetu këto inqizimi. o tu ndodh i ki bisedo me krejt menaxhmentin atje a e kemi nal naaju kane nal rryma me ketu oshte. Meqense edhe un personalisht jepi vrejte domethene edhe Kosova pressin, sepse neve te fundit nuk na intereson a na let rryma as na let rryma. Neve na intereson me pas transmetimin edhe mos me pa shkru ti as niher transmetimit me asni seance. Edhe këta do ta boj edhe me shkrim. Mos sot neso qe domethan do ti drejtohem menaxherit ose e ndërume menaxhere kontrates me ja percjell une niher u kam percjell ni vërejtje me shkrimt e ta e dini ju kom jap kopje edhe juve dikush tjeter per fjalë? Eee, drejtoreshë kryetar. Drejtoresha për buxhet e financa ka fjalën.

Dafina Caca

Fillimisht po filloj prej fundit, për arsye se më të arrij pjesën se sindikatat. Sindikatat nuk nënkuptojnë që na ju kem thirrë para tyne. Po janë mjetet e cilat ju dahan nga paga punëtorëve për kontributin në sindikate anëtarësimin që e kanë ata në sindikatë nuk nënkupton që këtu na kem dhënë pare për sindikatën, për organizime të ndryshme, sepse është në kategorinë ku është paga neto, sa ju ka dalë tatimi, kontributi funksional, sindikata, odat ruajtëse, provaja e punës e tjera janë nda me secila. Po ashtu dua me theksou se Komuna e Deçanit e ka një buxhet shumë të vogël edhe pjesa më e madhe e sajna shkon 8 miliona afër janë vetëm për paga, që domethënë 7 miliona mbeti për shpendime të tjera. Vendimin të cilin e ka marrë Ministri i Financave për mos tërheqimin e mjetëve nga kategoria e pagave, sidomos për shujtat e ne arsim, neve na ka dëmtu ma shumë, sepse pjesa më e madhe e mjetëve që i morëm janë në kategori të tjera kapitale, madhura, subvencione, komunale etj që janë në vlerën prej 3.5 milion edhe vlera më e madhe e tyne takon shujtave n arsim, që domethënë nuk është na ka mbetur neve hapësira shumë e madhe mbi poshtë shpendimet elementare. Lere me mund me keq përdorë, sidomos për periudhën e fushatave, sepse përmenden mjaft 5-10 herë deri qetashti. Viti 2025 ka qenë shumë sfiduese për të gjitha organizatat buxhetore, jo veç për Deçanin, sepse kemi mbet vetëm me shpendime elementare në pjesën e fundit të vitit edhe ata me mi kry një pjesë të obligimeve. Po po ja sqaroj për juve gjithëve që jeni për herë të para asamblesë dhe e keni dilemin e kodeve ekonomike ose emertimeve, të cilat janë të obliguar nga thesari dhe nuk është që na i vendosim ketë emër. Mirpo duhet mu përshtatë për shkak se kur dojmë me bo një zbatim të mjetëve duhet të përshtatesh kategorisë së siles i takon, sikurse shërbimet keshilldhënëse, shërbimet intelektuale, kontraktuese tjera. Shërbimet këshilldhënëse dhe intelektuale nuk nënkuptojnë vetëm kontratat mbi vepr, sepse nuk kemi punësuar na tan at njeri. Mi marr tana kto paga. Pjesa tjeter 60,000 euro që përmendet asambleja janë mjetet e cilat që janë marrë për komisionet, jo ata këshilltar që ne kem pas ose tan ata njerëz që i ke marre oferta pi jashtit, por janë vet per asambleist, të cilët kanë qenë në komisione të ndryshme, të cilët janë pagu për punë të ndryshme që i kam bo se rregullor të ndryshme, të cilët mundim me pas edhe ju rasi me kon në këso komisione edhe me marr njetet e cilat t'ju takojnë, pra të takimit që i mbani si komisioni i pronave që u kon, komisioni i hartimin në një rregullore tjetër etj. Poashtu edhe për drejtori tjera kapas komisione edhe kem pas edhe kontrata këshilldhënëse, jo këshilldhënëse po ndoshta për hartimin e një rregullore qysh u kon rregulloja për sistematizimin e vendeve të punës, e cila është e paguar nga ky kod ekonomik që nënkupton shërbim intelektual këshilltandës ose i ndryshëm. Poashtu kemi edhe mirëmbajtje rutinore që nënkuptojnë mirëmbajtjen e ndërtesave, mirëmbajtjen e ry e ndriçimit publik ose mirëmbajtjen e kamerat qytetit që paguan për kompani të cilat janë të kontraktuara, që ju kisha lut me hinë në faqen e komunës edhe që është vegza e prokurimit. Mikqyr të gjitha kontratat që me pas me pyetje cila kompani jo kjo dhe cila kompani është ajo, se nuk jeme obligue me pru kompanit këto emra. Mirpo jeme obligue me e thu njera për financuar të cilat tregohen ku janë shpenzu mjetet, po jo kushi i ka marrë, sepse është shkeqi i të drejtave të njeriot. Ndërsa. Së bashku edhe dua të theksoj se transparenta buxhetore për Komunën e Deçanit ka rritë tetë dhe një përqind nga katër te dy kur une e kam marë pozitën. Pra, bazë në raportet e tjera unë i publikoja edhe i traduktoj te ju. Janë raportet e tjera të obliguar me ligj edhe janë shumë transparente. Për atë arsye edhe kemi ngritur vlerë vlerësimin për transparentëm buxhetor. E pagjesat e cilat janë bo për telefoni mobile, furnizim me kompjuterë, furnizim me naftë, dru janë të gjitha shpenzime të cilat kanë dalë nga kontratat e cilat janë lidhje

edhe paguhen. Për atë arsye, furnizimi me kompjuterë kem pasë furnizim edhe në administratë. Si të gjithë e dini që amortizimin i kompjuterisë është tre vjet edhe normal që duhet të furnizohim edhe sindrojmë edhe këto kontrata. Shumica nuk janë tanat, janë kontrata që janë të lidhura me atë që ben, mirë po naj bojmë përkeqësitë edhe furnizohem përmes përfituesve që atje janë përzgjedhë. Nuk i përzgjedhim na krejt e kemi rastin edhe me veturat zyrtare. I kemi blerë dy vetura të reja zyrtare, të cilat procedurat të gjitha i ka zhvillu niveli qendror. Ne jemi furnizues sipas kërkesës që e kemi von. Një veturë është për kryetarin, zyrën e kryetarit, ndërsa tjetra është për Departamentin e Tatimit në pronë për terren. Jom shumë e vetëdijshme që ka kërkesa edhe nevoja shumë adhuruese sa me i blejë njetët. Mirëpo, në terren edhe punëtorët duhet me pas kushtet për me dalë ose duhet fillimisht ti rregullojmë kushtet e punës toni me me kërkuar raport ose me kërkua rezultate të punës. Te trotuaret po ashtu janë investime në vijim, te cilat ë është kontrata e publikume ne në prokurim. Eh, pajisjet tjera, gjenerimet e rryme që është zerimi i ndriçimit publike është kontratë përfundim. Shpenzimet e varrimit ka qenë vendim i kryetarit komunes, të cilin edhe këtë e me hin faqet komunës, sepse me pa jetu veç këtu që u konë ni vendim i kryetarit bazë kërkesë se personave të cilët s'kanë pasë ni rast në familje. Kryetari iau ka me vendim i ka kompensu deri në 200 euro per shpenzimet, e cila ti kanë pasur po ashtu janë e ajo që ke investimi për objekt administrativë ose objekte që janë të sportit janë investime në vijim si pishina edhe investimet tjera, të cilat unë nuk muna mi përmend veç veç me emra, sepse muna mi ngatërru ose me e harru ku jemi për momentin tu investu. Janë investimet që janë tashë e tri vjet ose tashë e dy vjet, të cilat janë në vazhdimsi. Nuk janë pagesë e njëhershme ose pagës vetëm për një rast. Së neve na u ka tek.

Po kemi lidhje kontratë edhe jemi mundu që me i pagu sa më shpejt obligimet e tilla kanë dalë nga cila kontratë edhe shpresoj që edhe në vitin 2026 nuk kem me pas shumë sfida që dalin nga kontratat kolektive dhe vendimet gjyqësore që të mundemi shpenzu buxhetin ashtu qysh e kemi planifikue. Faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Drejtoresh, faleminderit shumë. Koleg, në bazë të rregullues që ja kom jep, Neni 13 pika 5 thotë çdo anëtar i Kuvendit ka drejt të diskutojë për një pikë të rendit ditës vetëm një herë në kohëzgjatje prej 5 minutave. Pika 6, anëtarët e Kuvendit mund të replikojnë vetëm një herë njëri me tjetrin për mendime shprehur në rastin e apostrofimit të emrit nga parafolsi gjatë diskutimit për çështje të caktuara. Replika zgjat deri në një minutë dhe replikat sigurisht do të jenë korrekte edhe jo fyese. Ë, nuk e mbaj mend që ju ka përmend emri.

Rregulloria me shumë respekt. Unë m'fal veç. Po. E vërtetë, e vërtetë. Të paktën na qet rregullore është miratuar prej një kuvende komunal. Nëse shihni që sigurisht mund të na pasë mangësi, mund të me kriju ni komision që munden për me e bo plotësim ndryshimin e saj. Unë për momentin po referohem në rregullorës qe osht n'fuqi shumë e kjo art mundem me pas. Domethënë, por kështu është rregulloria. A mundesh me lexue? . Faleminderit shumë. E nderueme. Faleminderit shumë plus për mirëkuptim.

Në rregull e nderume, nderuame! Kryetarja ki kërkua fjalën, plus ani ok, na qesim e boj me inicon procedurë. Na jemi në rregull.

Faleminderit shumë. Faleminderit shumë.

E nderume E para kisha lut me përdor fjalorin korrekt jo ofendus. Sepse, sepse, sepse, sepse, sepse m'fal, m'fal nuk kem bre

Yll, a ka mundesi me kalu fjalën te Kryetari

Bashkim Ramosaj - Kryetari

Faleminderit, kryesus! Faleminderit gjithë anëtarëve të Kuvendit që janë përfshirë në këtë debat me pyetje e me shqetsimet që i kanë, dhe po ashtu me, me interesim, sepse roli juaj është ky, kontrolli ndaj ekzekutivit dhe ndaj supozimeve që mundën me, me qenë edhe, edhe shkelje edhe keq menaxhim edhe, ndoshta keq klasifikim, që oshtë detyrë e një institucioni krejt tjetër. Edhe po ashtu, edhe obligimi imi edhe obligimi drejtoreshes sipas autorizimeve që i ka, oshtë që me u përgjigjë shqetsimeve që ju i nritni mrena kësaj seancë për raportin financiar për vitin e kaluar. Edhe osht tepër korrekte, oshtë shumë me rëndësi, që në këto përgjigje me u përgjigj sa më korrekt dhe sa me saktësi, që mundet të majt evidencë për krejt pyetjet dhe shqetsimet që kanë ndodhë. Eh, fatkeqësisht jetojmë në një kohë ku, shoqëria jonë osht tuj u përballë me llapërqitjet politike, të cilat qytetarët e kanë për detyrë me e bo konfuz, që njerëz që merrne këto llapërshritje kanë për obligim me kriju ni populizëm përballë publikut. Ë, m'pëlqej, m'pëlqej në krejt tendencën e sotshme në krejt argumentimet që i boni anëtar, që i bonë anëtarët e Kuvendit, ëh, një shprehje që mra për herë të parë me lexu, që osht aktakuzë politike. Dhe unë ju inkurajoj, jo me pas aktakuze të politika publike o me pas

akt akuzë pranë organeve të rendit, që ketyne temave mju shku deri fund. Ëh, për shkak që gjith ne qe jemi ktu, pavarësisht jemi persona individual, mirpo e kem ni karakter, e kemi ni origjinë, e kemi ni familje, përfaqësojmë diçka, do duhet të jemi të kujdesshëm e më njëri-tjetrit, sidomos kur diskutojmë. Jemi sa ma argumentues. Për pjesën e hartimit të një raportimit tillë, mundem me pas dilema gjithmonë. Për mënyrën e spjegimit, mundem me pas vretjet gjithmonë. Për mënyrën e shpenzimit po ashtu, mundem me pas gjithmonë dilema për keq-përdorime, për keq-menaxhim paras publike. Mirupo që i trajtojmë, e në rast se nuk i trajtojmë bashkë, atëherë shqyr që në këtë shtet jon jep mundësitë, e kriju mundësitë, që me pas mekanizma institucional, ligjor, të cilet, të merren me këto, me këto tema. Edhe shqetsimi tjetër që nuk osht hera e parë që po na ndodh, osht shqetsimi me mediumin të cilin kem kontratë me transmetu, live qeto seanca. E kisha pasur shuf që mos me kon këtë shqetsim, në asnjë mbledhje tjetër të Asamblees. Për shkak qe osht e besueshme kur nalët transmetimit që dikush ka nderhy, pavarësisht a ka nderhy KEDsi, a KOSTi, a ZRRE-ja, a kush dreq I mallkum. Në seancë, seanca duhet me transmetu, edhe në rast se ka fymje, edhe në rast se ka gjana krejt negative duhet me dalë në media. Faleminderit, kryesus!

Hajdar Sutaj

Falemnderit, kryetar! Ë, Ardian Binakaj nga LDKja ka fjalën.

Ardian Binakaj

Ëh, po, fillimisht e falënderoj zonjën Cacaj per sqarimet që na i dha. Megjithate unë kisha dasht me u ndalë prap te pika e te hyrave tatimore per vitin 2025, te planifikuara 537,615 euro, Nuk keni mbrri me I realize 142,000 euro. Ia keni huq per tridhjetë përqind. A e keni bo analiz, pse ka ndodh kjo? Çka muni me ndryshu? Çka ka ndikuar edhe qysh e keni planifiku këtu? Kisha pas qef me pas ni përgjigje. E dyta anomali që cka smu përgjigje osht për shpenzimet te kontrollav teknike. Keni pagu 390 euro. Pi bin rreth, prej afërsisht, po llogarisë trembëdhjetë vetura. I keni pasur me kontroll teknike. Për po këto vetura, si ju po besoj servisoni veturat komunale, jo private. Keni pagu 35,000 euro servis . A ju e keni ndrru krejt motorat, karoserinë, a qa keni bo me këto, nuk e di. Unë, personalisht, edhe gjith grupi parlamentar lidhur me këtë, distancohem nga gjuha e sharjve dhe fyrtje që përdoren në Asamble. E në njeften kohë nuk nen kupton që vendbanimi domosdo osht edhe dije. Njeri mund t'jetojë edhe në Prishtinë, mund t'jetojë edhe në Deçan, po aftësia matet me krejt diçka tjetër, jo me vendbanim. Andaj, ju kisha bo thirrje, mu distancu nga kjo gjuhe kush ku banon, se ju keni edhe anëtar që janë pjesë e legjislaturës ketij here që nuk banojnë Deçan, po megjithatë janë asamblistë te AAK-se. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Perseri, faleminderit edhe, edhe juve! A ka dikush tjetër prej atyne që skan disku qe don me marr fjalën? Po unë. Unë po foli për rregullorën e punës. Po, ok.

Faleminderit shumë! Ëh, dëgjo, nuk ta kom jep fjalën për shkak se e respektoj rregullorën. Jom i obligum me respektu rregullorën. Absolut tpakten ka ni Vendim të Kuvendit. Unë ti inkurajoj juve me gjithë respekt që me iniciue plotësim ndryshimin. T'lutna, t'lutna, t'lutna osht mbledhja e par rregullt e kësaj legjislature, a po kupton at her naj ju mundni për me fillue edhe me iniciu zyrtarisht procedurën për plotësim ndryshe të rregullores. Edhe unë jom për që me fillu procedurën për ndryshim.

Në këtë momentin është kjo rregullorë në fuqi. Është votuar në një komision i cili është hartuar prej të gjitha subjekteve politike. Dhe tash e nderume, fushata u kry edhe të kisha lutur që me ju përmbajt rregullores. Drejtoresha e ka fjalën. Po. Ëh, falemnderit shumë drejtoresha Dafina Cacaj, e cila e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Ëh, në lidhje me të hyrat, na i kemi marë disa hapa, të cilat i kemi dërgu disa, , për të gjithë ta tatim pagesit, ëh, njoftime edhe letra njoftuese për obligimin edhe për pagesën. Mirëpo, zyrëtarin për mbledhjet e detyrueshme nuk e kemi. Shpresoj që shumë shpejt hapet procedurat edhe të merrët edhe zyrëtarin për mbledhjet e detyrueshme. Po ashtu, ëh, jemi duke u mundur me shtu stafin, sidomos për terren, për verifikim edhe që sa më shumë me mujt me mri edhe verifikimin 20%, po ashtu edhe inkasimin, sepse është fakt e vështirë për shkak se janë obligime më të vjetra edhe qytetarët tani më, derisa ligji nuk po na obligon me i dërgun në publik, në permbarim ose procedurat tjera. Atëherë ajo nuk është, nuk, nuk kemi ni mekanizëm tjetër që na me obligu qytetarin me e pagu tatimin ne pronë. Ndërsa atë servisimi dhe kontrollat teknike, kontrolla teknike që janë bërë për regjistrim të automjeteve, ëh, të cilat ju kanë skaduar regjistrimi, kanë qenë kaq të cilat i kemi bo. Po dikuj ma herë dikuj ma vonë. Ni pjesë të fundit që i kemi regjistru, kompania na ka prit për arsyet se nuk kemi pasur mundësi buxhetore me pagu. Tash i kemi kry, ndërsa servisi i automjeteve, ëh, janë automjete të vjetruara, sidomos të zjarrefikjes ndërsa kanë, ëh, edhe kosto ma te madhe. Kanë edhe,

ëh, prishje më të shpeshta se janë në terren gjithë kohen. Janë edhe QKMF-s, shtëpia rezidenciale, po ashtu edhe, ëh, pajisjet e komunës ose veturat e, e administratës, të cilat këtu i kemi ma pak. Të gjitha këto gjatë vitit, për prishjet që kanë ndodh, ka qenë kjo kosto, për shërbimet e zjarrefikjes Nuk është obligim ligjor i komunës, mirëpo janë të komunës se Deqanit dhe duhet të ti kryjmë obligimet ndaj tyre ose tju rrim gati, sepse ligjërisht, edhe pse nuk na takojnë të gjitha shpenzimet, i kanë prej komunës dhe çanit. Edhe pagat ju kanë mbetur te na edhe të gjitha shërbimet që i kryjme ose shpenzimet që dalin duhet t'i kryjmë na. Për shkak të këtij agjencioni nuk merr përgjegjësi për këtë pjesë. Unë diçka tjetër nuk kam. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtoreshe. Albesa Cacaj, e ka kërku fjalën.

Albesa Cacaj

Po. Kom përgatit edhe për raportin financiar. Po me që koleget e mi nga LDKja, ëh, e shqyrtun në detaje, nuk po zgjatëm te kjo temë. Tjetër që e mora fjalën, kryesus, që të implementimi ose zbatimi i rregullores. Tu kisha lut me që është mandati dytë i juaj, mos me përdorur standartet dyfishta. Sdi a tkujtohet kryesus, kur unë merisha fjalën mandatin e kalum, kur t'flas, flas unë, pastaj e merr fjalën ti edhe ma ndalshë fjalën, pa u bo tre minuta. Deri sa ta rekomandova unë si asambleiste që mere, lexo, shqyrto rregulloren, pastaj hajde mbaje mbledhjen si kryesus. Kështu që me këtë mandat, të paktën mos përdorë standartet dyfishta, kur ty t'konvenon me implement e kur jo, nuk është e drejtë. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Ëh, faleminderit shumë për sygjërimin, shumë respekt. Ëh, Florim Mataj ka kërku fjalën.

00:04:03,220 --> 00:05:23,250 [speaker_2]

Ëh, nuk dashta me u nderlidh në raportin financiar. Me këtë temë dashta mu nderlidh pak osht Mandati tretë që jam në Asamble, dhe jam prej atyne edhe po ju bej thirrje edhe pozitës së bashku, që aty ku flitet fjalia, hajni ofendime, vjedhje, shkojmë së bashku në prokurori. Ka institucione në kete vend, që munden me vlerësu edhe marr deri në përfundim. Kështu që kërkesa jemi është që të paktën mos kalojmë në ofendime personale. Jemi koleg, jemi bashkëvendas, të gjithë t'i diskutojmë temat, po jo në këtë qasje qysh e kemi nis. Sa i përket rregullorës, e dime t'gjithë, është e qartë rregulloria. Urdhnoni e propozojmë, mundemi të ndryshojmë rregullorën, me bo ni rregullore tjetër. Kështu që ta ruajme gjuhën me, ta, ta ruajme gjuhën e komunikimit. Flasim pak ma, ma, ma, me kembe në toke. Besoj që, u kry procesi zgjedhor, kanë përfundu zgjedhjet. Është rezultati ai që ke marrë qytetari. Jua ka besu, i ka besu prapë kryetari Ramosaj, i ka besu Aleances për Ardhemerine e Kosovës. Kështu që për këto katër vite, mas katër vite shkojmë prapë zgjedhje. Kështu që besoj që duhet me hek atë sindromin e zgjedhjeve. Ka përfundu ai proces. Ta ruajme gjuhën e komunikimit, kaq kisha. Edhe njëher, ju bej thirrje, çdokush që e sheh që e perdore fjaline, hajni, urdhnoni, ka prokurori, ka gjyq, ka institucione. Kaq kisha.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Florim. A ka dikush tjetër prej atyne, se s'kanë diskutuar? Hyri ki diskutu. Po përbesë, fillojmë. Ókej, falë, falënderit po Albesa m'ka kërku mos me pas standarde të dyfishta. Jom i obligum me respektu rregullorën. A ka dikush tjetër? S'ka. E kalojmë si pike t'rendit e ditës. Jemi te pika e shtatë. Shqyrtimi i Raportit Planin të Integritetit për vitin 2025. Edhe e kemi përgjegjësen Ajne. Iberhysaj, te cilen fillimisht ja kaloj fjalën edhe e lus që ta shfrytëzoj foltoren për fjalë.

Ajne Iberhysaj

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! faleminderit Kryesus! Atëherë raporti i planit të integritetit për vitin 2025 është bazuar sipas planit të integritetit për vitin 2023-2026, i cili plan është miratuar nga ish Asambleja Komonale dhe ky raport me të gjeturat, i cilat kanë qenë të planifikuara identifikimi i këtyre problematikave, të që kanë qenë të prapara në planin e vitit 2023-2026. Për vitin 2025. Në raport, që unë kam, jam e caktuar nga kryetari i komunës, për ta monitoruar zbatimin e këtij plani, të dhëne, përveç kryetarit të komunës që unë raportoj miratimin e këtij plani, raportin e bën Agjencioni AntiKorrupsion. Atëherë për vitin 2025 për gjashtmujorshin e parë janë 17 të gjetura identifikuar vlerësimi i tyre dhe përcaktimi i masave që ka marrë ekzekutivi. Në plan të integritetit monitorohet Zyra e Kryetarit dhe gjithashtu edhe ekzekutivi, dhe në raport janë për gjashtmujorshin e parë siç theksova 17 të cilat janë të, me masa përkatëse me linqe përkatëse që janë të prezantuara dhe në webfaqe të komunës. Për gjashtmujorshin e dytë janë 15, por gjithnjë dukur bazuar në Planin e integritetit dhe miratimin e këtij raporti të bon Agjencioni Antikorrupsion. Drejtori ekzekutiv Burim

Sadikaj, të cilin unë kam përcjell edhe e mail-in bashkë me raportin gjashtmuor, ah, të vitit 2025 dhe gjithashtu gjashtmuorsh i dytë të vitit 2025. Pra, në fjalë. Për detaje tjetër unë jam këtu, dhe jam e gatshme t'ju jap pra mendimin, por është njëra prej punëve më të ndjeshme, të cilat në qofëse gjatë verifikimit të ofrimit të dhënave të, përveç identifikimit, vlerësimit dhe zbatimit të masave të cilat kanë ndermarr Zyra Kryesore dhe varesit e tij, nëse nuk verifikohet pastaj unë si zyrtare e caktuar për të raportuar monitorim dhe zbatimin e planit të integritetit penalizohem. Është një prej përgjigjesive, të cilat kërkon përgjigji gjatë ofrimit të dhënave tek Agjencioni Antikorrupsion. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, zonja Ajne Iberhysaj. Po fatjetër. Atëherë ne, në lidhje me ky raport planit të integritetit. Fillimisht, nëse ka dikush nga radhat e AAK-s grupit parlamentar, deputeti, jo, prej LDK-je, Ndriqim Çekaj .

Ndriqim Çekaj

Falemnderit për fjalën. E kom lexu raportin. Planin, për Planin e integritetit dhe Raportin e zbatimit të rekomandimeve. Janë dy pika kogja shqetsuese me të cilat I kena vrejt edhe në raport, sidomos në pjesën e dytë të korrik-dhjetor. Ka të bëjë me pikën numër shtatë të prokurimit, edhe me pikën katërmëdhjet tek pronat. Kërkohe një azhurim më i madh i listës së pronave prej asaj që janë publikume më herët. Ndërsa sa i përket prokurimit me të vërtetë është shqetsuese, sepse siç dihet përmes prokurimit kalojnë gjitha aktivitetet financiare për projektet e komunës dhe aty është një vërejtje e madhe. Për sa i përket publikimit të kontratave, thuhet se janë publikuar vetëm pesë kontrata në, në, në webfaqe te komunës ose ashtu siç është e organizuar ky aspekt. Marrë parasysh faktin se si e pam te raporti financiar se si trajtohet paraja publike, atëherë me të vërtetë kjo është një shqetsim. Por sidoqoftë jemi këtu e do të merremi në vazhdimësi edhe me ket segment rëndësishëm të qeverisjes siç është prokurimi. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit po ashtu. Dikush tjetër prej atyne që dëshirojmë të diskutojmë në lidhje me kit pikë? Po? Përfaqesuesja e PSDs, zonja Natyra Kuçi, pastaj zoteri Shkumbin Demaliaj, perfaqesues i PDK-s

Natyra Kuçi

Ah, për mu rëndësishme janë disa pika, ti ceki tri që mos u mu zgjas shumë, se ket raport mundem me pa gjith. Për mu është i rëndësishëm që sektori i turizmit është cek që ka mungesë plani të zhvillimit të turizmit. Ëh, kam diskutu gjatë edhe besoj që një prej problemeve të Deçanit është që ka potencial tepër të madh për zhvillimin e turizmit. Në ndërkohë që nuk e ka të mirë organizume ni plan afatgjatë se ku don me mrri dhe qysh don me mrri, në kuader të, ëh, një tërësie që kish mujt me i sherby Deçanit. Qoftë tu nis prej tregut, qysh kish mujt me i ndihmu turizmi bizneseve të vogla? Qysh kishim mujt me i shtu kapacitetet e akomodimit? Pra mu bo me plan, përmes ni, ëh, një plani afatgjatë, ku e dimë kater vjet e ardhshme ku kemi me shku, e jo turizëm ad hoc n'shërbim të grupeve të ngushta të interesit, i cili realisht nuk përkthehet në të mirë qytetarëve të Deçanit. Pra nuk ka kurgjo të keqe me ardh turistat në Deçan. Po i shkon mirë, aq ato kapacitetet komunës që përdoren për turizëm edhe mu kthy e qytetarëve të Deçanit në ni formë apo tjetër. Pika tjetër është zhvillimi ekonomik lokal. Edhe këtu është qëllimet dhe prioritetet të zhvillimit ekonomik paqartë dhe jo transparente. Pra nuk e kem, ëh, ni qëllim ekonomik se ku duam me mrrer si komunë, po pak a shumë janë vendime ad hoc të marra, ëh, aty për aty. Ëhëë, Standartet e ndërtimit dhe kontrollit për mua është shqetsuese që ndërtimet ëëë... Është edhe gjetje, keq mungesa e kontrollove konsistente mi ndërtimet vend, vendpunisht. E di që qan tu bo, ëhë, duhet mu, ëhë, me qenë kontrollera të ndërtimit të repta edhe të vazhdueshme, sepse është një prej shqetësimeve, ëhë, gjithqytetarëve të Deçanit. Na e dinë që përveç kritereve të ndërtimit që janë prej objektit në objekt, ëhë, femijet nuk munen me shku në shkollë, nanat me fmit e tyre për shkak që vendpunishtet jonë nëpër trotuare, ëhë, një prej, një prej gjanave, ëhë, duhet me qenë inspektim i rreptë, ëhë, i ktyre vendpunishteve për disa sfera, jo veç që i pengojnë trotuarët, por edhe kriteret për hapësirën e gjelber që janë zero e tjera që i kemi diskutu gjegjesisht. Këto kenë tri pikat që, ëhë, për mu kanë rendesi te veqant.

Hajdar Sutaj

Zoti Shkumbin Demalijaj, ka fjalën.

Shkumbin Demalijaj

Ëhë, falemnderit, kryesues! Është interesant se na kur dojme me marr fjalën e gjejme mundësinë. Edhe kjo mundësi na jepet, se jemi zgjedhur edhe 1 herë vërejtjen po e jepi përfundimtarës. Edhe ditën e parë nuk keni qenë ende i zgjedhur. Kam propozu kandidatin e dytë nga anash. Interferohet, i thuhet ne, apo doni ti me u

kandidu? Domethënë njerëzit që u teket pa kon i zgjedhur ndërhyjnë në sallë. Këta merre si rregull se nderhyrja ndaj delegave, nga stafi apo njerëzit që keni përcaktuar ose nuk i keni përcaktuar, ju më kon pjesë, se ai letrat me njerëzit e zgjedhur nuk ka diskutim. E keni drejtë, unë ja e fjali le t'fol gjithë ditën, s'na pengon. Pjesa këtu po e shoh se, gjithçka çka ka lidhje me antikorrupsionin në Deqan nuk vlen edhe ky raport nuk duhet me na ardh ma, se sipas juve gjithçka këtu lulzon ose gjithçka ën rregull. Ëhë, vetëm pikën e parë këtij raporti... Në rendin e parë të udhëheqja dhe menaxhimet po e tregojnë një veshitësi që e ka përcaktuar në raport, këtij raporti. Mungesa e njoftimit, stafit, të vështirësi, për sistematizimin e vendeve të punës, edhe mungesa konkurse për pozita tjera për shkak të pensionimit të stafit. Nuk po di mo diçka çka ka me thonë, domethënë qysh në start dihet se qysh luhet roli me konkurse edhe pjesë tjerë, edhe besoj se, këto raporte mos t'na vinë mo përderisa sipas juve gjithçka këtu osht në rregull. Kaq pata.

Hajdar Sutaj

Faleminderit. Po. Faleminderit. Dikush tjetër? Sylë Balaj, nga radhët e LDK-së.

Sylë Balaj

Ater, përsëndetje për gjithëvë. Plani i integritetit nuk duhet të mbetet dokument, n'fshirrtar. Integriteti institucional nuk matet me planet e miratuara, por me praktikë të përditshme, me vendime të drejta dhe, në refuzim, tek keqpërdorimit. Pa transparencë, pa përgjegjësi dhe pa ndëshkim, të shkelëve. Çdo plan integritetit mbetet letër. Ky Kuvend duhet të jetë shembull i etikës publike. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, zoti Balaj. Dikush tjetër? Aternej, ëhë, a ki diçka me shtu e nderume? Ajne Iberhysaj.

Ajne Iberhysaj

Te hartohet në plan, duhet të identifikohet problematika. Çështja te cilën pra duhet të jepet pikerisht pra veprimet përkatëse. Te pjesa e dytë e matricës është dhonë veprimi i përkathës që ka marrë institucioni ekzekutivi. Ky, duke raport, ka kalu filtrat. Nuk e kom marrë miratimin nga kryetari i komunës, po kom marrë miratimin unë që ju kom përcjell email-in, e drejtorit ekzekutiv të agjencionit, ëh, që është miratu. Ne qoft se nuk do të kish marre konfirmimin nga agjencioni, unë do të isha pikerisht duke vazhduar derisa, ëhë, ato, ëhë, të gjetura që nuk janë përmisu, duhen të vazhdon të përmisohen. Dhe kjo është për mu njëëë, unë ju thash që në fillim, është një prej raporte më përgjegjësi më të madhe. Ne qoft se nuk afrojmë me dëshmi të sakta, të verifikueshme, të pranueshme, atëherë edhe unë si zyrtarë që kom përgjegjësi nga kryetari i komunës, mbar përgjegjësi penale. Mos ofrim të dhënave te cilat janë të paverifiku. Deri me tani, Agjencioni Antikorrupsion e ka vlerësuar, ka miratu raportin gjashtë-mujorshin e parë dhe gjashtë-mujorshin e dytë, te cilin ju kam përcjell bashkë me këtë raport edhe emailjet e drejtorit ekzekutiv. Për çdo gjë tjetër unë jam k'tu edhe për çdo përmisim tjetër ne jemi bashkë në punë, po faktikisht ky raport i takon zyrëëë, kryetarit dhe varësve të tij. Dhe miratimi i kti, ëhë, ka qenë obligativ me dal para asamblesë, për arsye se në vitin 2023-2026 ky plan është miratu nga ish legjislativi, ashtu siç theksova gjatë prezantimit tim. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Ëh, faleminderit, zonja Ajne Iberhysaj. Meqenëse edhe nuk jam të, ëhë, lajmëru tjerë për diskutim, e kalojmë si pikë, këtë raport planit dhe vazhdojmë te pika tetë, që është marrja e vendimit për hartimin e draft rregullore për plotësimin e kushteve teknike, për lokale afariste në territorin e komunës së Deqanit dhe formimi i komisionit për hartimin e kësaj draft rregullore. Zonja Ajne Iberhysaj me qenë se jeni, eh, pi, drejtor, ëhë, a doni diçka me thonë lidhje me këtë propozim kësaj pike? Atëherë dhezmi mikrofonin te drejtori Ibrahim Selmanaj

Ibrahim Selmanaj

Eh, përsëndetje për të gjithë. Unë, ju uroj një punë të mbare të legjislativorit ri, dhe kam përndert që të prezantoj, ëhë, një rregullore cila mungon, ëh, ne komunën tone, dhe në kuadër të procedurave që shi dhe i parashëh edhe Legjislativori edhe Kuvendi kërkohej që të hartohet një komision, të formohet një komision që ti ka me përcjell hartimin e rregullores. Ëh që bëhet fjalë për pranimin e kushteve minimale ëh higjenike për lokale afariste në komunën e Deqanit. Në këtë drejtim sigurisht se kryesuesi sqaron po procedurat veç ka filluar edhe duhet të harmonizohet edhe të zgjidhet komisioni.

Hajdar Sutaj

Falënderoj shumë drejtor. Fillimisht komisioni, domethënë na kemi me marrë si Kuvend vendimin për të, me e bo Komisionin, i cili harton kit draft rregullore. Aq unë jam informuar, Komisioni do të përbëhet prej gjashtë anëtarëve, tre do të jetë propozim nga Ekzekutivi, dy nga Kuvendi dhe njëra nga shoqëria civile. E kisha lutje që propozimet nga Ekzekutivi fillimisht ti kemi emrat e tyre. Ëh nuk e di nëse... Ëh më gjase, tre nga Ekzekutivi, dy nga Kuvendi dhe njëra nga shoqëria civile. Po.

A ka mundësi me dheze Mikrofonin te Kryetari?

Bashkim Ramosaj - Kryetari

E ksha pas ni sygjerim. Nje perpunim qofte e ekzekutivit qoftë asamblesë, e që për rregullorët, ëh, spozorizohen prej nje drejtorie.

Mos me pas komisione të formme në Asambelë Komunale, dhe mos me ndodh ne asni rast, pertej atyne qe jane strategji, qe kane pergjegjsi edhe afatgjate, mirepo qe kan pergjegjsi ma delikate nese mundem me quajt keshtu, ne kete rast me sa jom I informun prej drejtorit Selamanaj edhe prej stafit, rregullorja eshte veq ne perfundim e sipër në rast se I dua nje bekim edhe prej anëtarëve të asamblesë jemi ok. Po që kjo zakon, për pasi që është faza e pare e duhet mu draftu kjo rregullore. Qitne draftone masanej diskutone me publikun. Bone ni komision, prej asambles I cili kish mi marr kto vrejte, marrë sugjerime, --(nuk kuptohet)-- Ëh, se paku kishas pas qef, që qdo kush qe kish pas me sponsirizu nje rregullore, Me qenë hartues vet me ni ekip te stafit administrativ. Dhe mandej me referu perballe asamblesë po per diskutime publike qe kish mmujt me marr miratimin. Ëh, e kom ni praktikë që osht krejt personale, që o prej kohë se --(nuk kuptohet)-- Hartua rregulloren. Ka mujt me punu ni njerëz, dy njerëz, kurse pjesa tjeter komisionit nuk osht si kom qenë shumë ne ekspeditiv ose shume frytdhanes ne keto komisione qe jane . Vendimi është I juaj se doni të veproni, po është një prej sugjerimeve. Edhe lutjev tmia thjeshtë mos, mos i komplikoni.

Hajdar Sutaj

Kryetar, falënderit shumë. Jo referova kërkesës për renin e ditë sqë e kanë pru, sepse në rendin e ditë që e kanë pru drejtorija, thuajë ndër tjerat që është edhe formimi i Komisioni për hartimin e kësaj draft rregullore. Të paktën kështu na ka ardhë edhe nëse ashtu, atehere ne na jemi te obligum sepse draftin nuk e kemi. Fillimisht, sipas kërkesës që na ka ardhë tparen ditë, duhet me u bo komisioni, masanaj ne duhet me e pru draftin, me shqyrtu Kuvendi Komunal draftin e parë, masanaj me i nenshtru debatit publik, edhe me ardh shqyrtimi përfundimtar edhe aprovimin ose mos aprovimin e tij. Kështu që, kisha lutje fillimisht, kësaj rrade, të paktën me qenë si rend dite, nëse doni na majt të ndryshojmë si pikë edhe ktu mrena për...

Jo jo veç për qet rregullore. E kështu që herave tjera kryetar, rregulloret e cilat i harton ekzekutivi atëherë nej mundemi mos me na ardh si pike rrande ditë që me bon a komision, a ka mundësi e që t'i kemi tri propozimet prej ekzekutivit, ta kemi një nga pozita, një nga opozita? Po patjetër. Ëh, m'falni, ateher shefi grupit të AAK-s Florim Mataj ka kerku fjalën, pastaj po e qes edhe ta diskutojmë.

Florim Mataj

Ëh, me qenë që është pak edhe e pa kjarte, e diskutojë edhe kryetari dhe drejtori, atëherë ta kta sponsorizues, nese osht nevojë edhe le të rrin si pik e rendit dites

Bashkim Ramosaj - Kryetari

Edhe kryesia edhe koleget e mi që me e marr. Atëherë mos e, mos e levizni sepse oshtë shumë të thelbesore që kjo rregullore me me marr, me marrë rrug, për shkak se jemi ne anen ----. Nuk kuptohet, mikrofonin eshte shume larg

Hajdar Sutaj

Po falënderoj shumë këtë kryetar. Florim Florim. Florim. O Florim! M'fal që po drejtohna me emen. Zotëri Florim. Për hir të rrespektit, sepse na sjemi emra te perveqshem po jemi anëtar edhe koleg. Dhe kur nuk nuk I jepet fjala, nuk ingjizohet fjala juaj. Edhe keshtu deshta me thane qe pritni radhen, atehere a duhet me shfuqizu, shfuqizohet momenti kur vjen si drafte. A je ka kupton. Kshtu qe edhe e falënderoj drejtorin Jashar që mtha Komisionit me përba me numër tek, sepse unë e pasna tha me numer qift. Dhe atëherë ai le ti jetë qysh qe ju e mendoni. Hyri Dobrunaj

Hyri Dobrunaj

Po ma thu Kryesus? Në fillim e pashë që nuk ka material. Mirëpo, kur e dëgjova drejtorin e pashë që procedurat kanë filluar. Atehere pava që diqka nuk perputhet reni ditës osht gabim. Atëhere faktikisht nuk osht dasht me pru hiç si pikë rendi ditës, nëqoftë se nuk ka ni material, sa do pak qata qka aj e tha me fjalë material mbështetës. Për çka bohet fjalë? Mo u informu? S'ka pas këtu, po ksaj radhe ka mujt me ardh kshtu si material. Ënë në qoftë se veç kanë fillu procedurat edhe në qoftë se ni rregullore ekziston, asnjëherë unë propozoj me e pru këtu në Kuvend me diskutua ose si draft, me votua ose mos e votu, po mund të diskutu këtu në Kuvend. Po sa i përket komisioneve, kemi themelu komisione për gjithçka. Tash u pa raport financiar 60,000 na kanë kushtu nuk e di qfare pune kan kry, a kan kry a skane kry. Mirpo unë mendoj që reni dites ksaj radhe osht gabim, nuk osht dasht me ardh qeshtu si pikë edhe pa material mbështetës, pa material përcjellës. Na veç po e kuptojn tash i pas kanë fillue procedurat edhe ekziston ni rregullore që keni operu në bazë të asaj tash. A duhet me shfuqizu? A duhet me, duhet me e marr ni vendimin?

Hajdar Sutaj

Falemnderit, fjalën e ka kryetari Ramosaj.

Bashkim Ramosaj - Kryetari

Kjo pjese nuk ka mundur te transkriptohe sakte pasi qe mikrofoli eshte larg

-- osht obligim ligjor. Sidomos kur permendet, zbatimin, ndryshimin, harmonizimin e rëndomarës --- Drejtoria e Inspeksionit e kanë kërkuar se si kjo rregullore me operacion mu harmonizimin me u standardizuar tek e fundit. Jo, jo, kjo ka me u bërë rregullore. Dhe këta dhe këta kanë kërkuar. Aty s'kanë kërkuar. Këta kanë kërku me zgjedhë një komision që që këtë komision me u mbledh,. Si kjo kërkesë e kërkesa janë me keq që do të spozerizojnë. Ta mos me bo komision mirëpo që do. S'ta them undërmjet të tjerëve, por sa të thotë fjalësim. Boni i Komision dhe lart e mbush lehtë e ardhshme. Ne veni. Unë jam i gatshëm.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë kryetar. Atëherë unë falënderoj edhe për shpjegimet. Falënderit edhe sheshe grupit LDK-s Kisha thonë që meqenësi janë tre anëtarë nga ekzekutivi tre po shkojne prej Kuvendit edhe po, a ki diqka z. Demalijaj. Po patjetër. Demalijaj e ka fjalën.

Shkumbin Demalijaj

Po du me ndihmi n procedurë, sepse pe shoh qe nuk ju ka bo mirë. Pjesëmarrja gjatë në Asamble nuk jeni mar vesh mes veti. Kini ardh pa përgatitur për këtë pikë. S'keni pas kohë, e dimë festat e zgjedhjeve dhe krejt i kuptojmë. Unë besoj se këtu ekziston rregullore për çdo punë që rregullon qet fusheveprimtari. Po po kërkohe për mu ndërtu ni komision për me e ndryshu edhe për me met kjo në fuqi. Pika e rëndë e ditës duhet të përkufizohet plotësim ndryshimi rregullores dhe hartimi i Komisionit për plotësim ndryshimin. Ajo metet në fuqi që mes me met pa që qeshtje ligjore, pa funksion institucionit. Për në rastin që hin fuqi ndryshimi që e bon Kuvendi, ti e ki rregulloren e re. Po deri në atë periudhë, deri sa të botë e reja funksionon e vjetra. Kjo oshtë ndihma që muna mja u dhon për shkak se deri sa del ni ligj i ri, funksionon që ai i vjetri mire i keq. Do të thotë kërkim për plotësim ndryshimin e draft rregullores. Pjesa tjetër, kur e dëgjova kryetarin kur thot që ta formojmë ni komision që ti hartoj gjitha rregulloret e të punoj, unë nuk e di qysh muna une me punu në fushën e mjekësisë. Komisionet duhet me kon të veçanta për secilin veprimtari se duhet profesionistë ose po e bojm dikan le tmerret me gjitha. Falemnderit

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë. Kështu a mundesh, drejtor, me na jep ni shpjegim. Nëse u u bo pak situatë, ashtu a ekziston ni rregullore apo nuk ekziston? Okej, drejtori Ibrahim Selmoni e ka fjalën.

Ibrahim Selmanaj

Pak më shumë fjalë sesa punë është kjo temë e rregullores. Lokalet afariste duhet me pas ni dokument bazë që duhet mu pranë, cilat janë kushtet higjeno teknike sanitare edhe qysh ja ngjesim emrin. Nashta mundemi mi shtu edhe naj prapa shtesë. Çka oshtë më rëndësi. Duhet ta diskutojmë këtë rregullore edhe këta ka për

obligim drejtoria përkatëse, që është Drejtoria e Inspeksionit, ta ketë rregullore. N'ket drejtim. Drejtoria veç ka nis hapat e para për hartimin e rregullores. Çka duhet të bashkangjitet prej Kuvendit tash prej Asamblesë, një grup punues që e perpunon rregullorën si dokumentin tuaj dhe në diskutim publik. Edhe mas diskutimit publik vjen prapë për miratim në Kuvend. Thjesht duhet të bohet ni komision dhe merret në punë kur gjë tjetër.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë. Atëherë nese shkojmë me shtatë anëtarë të Komisionit tre. Ani unë u referova ato që më tha Ajnja. Tre nga Ekzekutivi, tre nga Kuvendi, një nga shoqëria civile. A mundemi e thonë te ekzekutivi emrat? Kushdo që I ka.

Falemnderit shume. Ftesa ka qene publike. Ne nuk e kemi domethene obligim per me ftuar ne qoft se ata kushdo qe oshte prej interesim mundet me ardh vet. Keshtu anetari i kuvendit lutna. A mundemi me shku me qene se po I zgjedhim dhe tre prej kuvendit e 2 jane nga pozita 1nga opozita Grupi Parlamentar. AAK Florim Mataj, veq sa te dhezet mikrofonti

Florim Mataj

Adriatik Alaj, edhe Laureta Zejna me qenë se s'kem pas diskutim paraprak, pe e boj nje propozim ktu tash se di.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë. Nga LDK shefja e grupit, Hyrije Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

Po edhe LDK ja mendon që është dasht mu konsultu biznesi me qenë se rregulloj aq tipikisht për ta. Po tash masi veç s'ka pas diskutim mpara prap e s'ken pas material, po qata edhe materiali na u kish d asht. Po e propozojme Syle Balaj.

Falemnderit shumë. Prej Shoqise Civile a kemi këtu dikënd?, Ah, falënderim shumë. Kështu kemi ni propozim prej zotëri Ibrahim Selmonaj, ë, Zonja Ajne Bërhysej edhe Zonja Dyke Lolluni. Ë, po ashtu prej Kuvendit Adriatik Alaj, Laureta Zejnaj dhe Syle Balaj dhe nga Shoqëria Civile Sanije Thaqi. Ë, e qesim votim. Ku osht për? [votimi] Falemnderit! A ka kundër? A ka abstenim? Ok. Atëher ne, ë, me 11 vota për edhe 1 votë kundër, është zgjedh... Ok, falemnderit. 2 vota kundër, ë, është zgjedh përbërja e këtij komisionit të cilin që ju urojme pune të mar. Të ndryshmet, të ndryshmet, realisht pikat tash të rendit ditë që kemi pikën e nëntë dhe pikën e dhjetë. E para është zgjedhja e Komisionit nga, DKA-ja për zgjedhjen e drejtoveve. E kemi këtu përfaqësen e Drejtorisë për Arsim, zonjën Violeta Kukalen, të cilën e ftoj te foltorja me e marr fjalën, që t'i jepë edhe propozimet për anëtarët e këtij komisioni. Qysh e thash edhe në fillim, përpara, ë, u zgjedh një komision për një vit, ndërsa tash ti, me ligjin e ri, para çdo procedure zgjedh ni komision i veçantë. Violete, fjala për ju.

Violeta Kukalaj

Të nderuar Kryetar, Drejtor, Kryesues, Asamblistë, urime legjislaturen e re. Pra, ë, ne si drejtori, mungesa e drejtorit momentalisht është në komandën e KFOR-it. Ë, ne si drejtori, ë, kemi hap konkursin bazë të rregulloret 19, vitit 4 për procedurën e emërimit të drejtorëve. N'ket rast, ë, njësi burimeve njerëzore ka hap konkursin për lanëselimin për drejtor e bën shkollën Lanë Selimi Lumbardh për drejtor. Prandaj në bazë të rregullores ne na duhet dy anëtarë nga Kuvendi me marrë miratimin e tyre, sepse vijnë nga DKAja, po domethënë kërkesa është dy anëtarë të Kuvendit me marrë miratimin, se kërkesa është nga DKAja.

Hajdar Sutaj

Atë herë ne, e nderuame. Ju, ju propozut që dy anëtarë, të cilët ju i kini propozu, ë, ta marrin votimin nga Kuvendi, po Kuvendi nuk ka nevojë më vetëm t'i votojë propozimet që ju.

Ateher, anëtari i parë nga DKA-ja eshte Zeq Malaj dhe anëtari dyti propozuar nga DKA-ja është Florenta Molliqaj.

Violeta Kukalaj

Pra nje anëtar është i punësuar në DKA-në, këtë rast Zeq Malaj, dhe anetari tjetër eshte qe punon ne institucione e DKA-s, Florenta Molliqaj

Falemnderit shumë! A ka dikush diçka me thonë, edhe pse? Po prej LDK Shefja e Grupit, zonja Hyrije Dobrunaj, e nderume shume falemnderit. Ulu dikun afer nese kem nevojë për naj për pergjigje.

Hyri Dobrunaj

Sa i përket kësaj procedure, LDK-ja absolutisht abstenon. As nuk voton, as nuk e diskuton, sepse materialin e kemi marrë sot. Ne çoft se, neçoft se duhet hiq. Nuk e di, nuk du veç me fol diçka sa me bon zhurum më sot këtu. Po nuk e di fare a eshte e nevojshme ky komision me votu këtu sot. Po edhe nese është, na absolutisht abstenojm. Nuk marrim pjesë në votim, sepse nuk jemi të informu për ça po behet fjalë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë! Ë, prej AAK-s, shefi I grupit, Florim Mataj

Florim Mataj

Dashta me u nderlidh pak më kolegen se na tu që pikat rendit i votum, kur e votum rendin e dites. Kështu që propozimet kenë e nderuar kolege, e kenë ma herët. Na morën si vendim u votu, kështu nashta u dasht qe kolegt tu me të informu pak që vendet. Kështu që ne nuk kena dicka me shut, e perkrahim propozimin qe te hidhet ne votim

Hajdar Sutaj

Zotëri Skumbin Demalijaj nga PDK ka fjalën.

DEÇANI

Shkumbin Demalijaj

Po Kryesus edhe lidhur me ketë rast, meqenëse po kërkohet votim nga Asambleja, kisha votu me ni kusht, me pas pru veç edhe emrin e drejtorit. I kishim kry meniher, Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit, dikush tjetër. Ndriqim Çekaj e ka fjalën

Ndriqim Çekaj

Atëherë, ë, po thoni që ka... Ne baze te asaj që e përmendi, ë, kolegja. Po thoni që ka ndrru forma e komisionit, domethënë tash duhet për secilin procedurës. Tash duhet për secilin rast me pas komision. Mirë. Qitu konkurset që janë publiku koheve fundit nJanar a e kanë pas procedurë? Për arsim që janë publiku rezultatet e çetyne konkursev për zgjedhjet, për drejtorat. Mire. Pra, mirëpo kështu, rregullt tash se pata nevojë që ti sqarojme, që kjo metoda me i pru, ë, pikat e shumt e rëndësishme të rendit ditës, mrena seancës është jashtëzakonisht praktiki jo e mirë.

Për shkak se nuk na jepën mundësi edhe mi studiu materialet edhe me pa se cili eshte interesi përgjithshëm. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Ëëë, I nderum koleg, e ki me drejtë edhe unë sot kam kërku që vetëm në raste kur kemi diçka tjashtezakonshme me ardh si pikë të ndryshmet se mi hi, ashtu. Perndryshe osht ardh sot edhe nuk kem desht me shku dej ka anulimi t'konkursit, ashtu edhe e kemi tek e fundit e votuam. A ka dikush tjetër diçka? Atoja që s'është votim perberjen e ketij propozimi prej dy propozuesve anëtarë nga DKA-ja, zotëri Zeq Malaj dhe anëtarja e dytë e propozuara nga DKA-ja, që është po ashtu nga shkollat Florenta Molliqaj. Ku osht për? Falemnderit. A ka kundër? Falemnderit. A ka abstinim? Falemnderit. Atëherë ne i kemi 11 vota për, i kemi 3 vota kundër edhe kemi 6 vota abstinim është miratuu uuh përberja e këtij komisioni. Jemi te pika e dhjetë që është formimi i Komisionit të Aksionerve të Ndërmarrjes Publike Komunale Hixhiena. Siç e dini edhe ngaaa herat e kalume, ky komision përbëhet prej tre anëtarëve që 2 i zgjidh, vijnë me propozime nga Kuvendi, ndërsa 1 nga Ekzekutivi. Uhm. E nderume oshtë votu tash si pikë e rendit ditës. Uhm, zotëri Florim Mataj, urdhnoni propozimet?

Florim Mataj

Na si grup I AAK-s propozojmë Adriatik Alaj edhe Kaltrina Ferizaj.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë prej ekzekutivit. Po është propozuar, po e kemi me emën Manjolla Shala. Atëherë naj komisioni i ka 3 anëtarë. Uhm, a ka dikush ndonjë diskutim lidhur me këtë temë, po Ndriqim Çekaj urdhno..

Ndriqim Çekaj

Të akcionarëve të ndërmarrjes publike Hixhiena. Uhm, me thonë drejtën, kur kom pa planin e punës s'Kuvendit Komunal, u befasova që nuk oshtë uhm domethënë themelimi i këtij komisioni gjatë rrugës megjathëse keni pa ketë gabime edhe mire që e kini permiresu, mirëpo kjo edhe kjo tash është ni lloj problemi tjetër që... Së kur uhm në pikën e kalume vjen domethënë brenda dite. Sidoqoftë është votu tash nuk... nashta eshte vone edhe me diskutu për këtë pjessë. Në fillim të seanes, thash që kom me diskutu diçka në lidhje me hixhienën, për mos me zgjatë, po do mi bo bashkë ne kete diskutim, që ka të bëjë me komisionin e aksionerve.

Hajdar Sutaj

A mundesh diçka veq mem mirekuptu?

Ndriqim Çekaj

Po.

Hajdar Sutaj

Nëse kem diçka veç sa i përket komisionit, nëse ki diçka veçant, e diskutojmë me tek të ndryshmet.

Ndriqim Çekaj

Ne rregull, nuk prish pune

Hajdar Sutaj

Ok. Po, nëse ki diçka veç për komisionin e propozum, urdhno.

Ndriqim Çekaj

Jo, nuk kam.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë. Dikush tjetër? Po, zotëri Shkumbin Demalijaj?

Shkumbin Demalijaj

Po edhe... Orientimin tim kundër këtij propozimi kisha mujt me thonë edhe me votë, po po e arsyetoj pse jam kundër. Domethënë direkt zyra e kryetarit dhe direkt ekzekutivi osht duke i mbikëqyrë domethënë kjo është ndërhyrje direkt e ni kompani komunale që oshtë Hixhiena me njerëz zyrës kryetarit, kryesisht sekretaresha e këtë pjesë. Kjo oshtë e pa mjaftueshme mo per opinionin publik, merrni nxerrni njerëz profesionist që din çka bohet aty, per zotin. Ma mos e vazhdoni mo me këtë temë, ta hi veç hajt me pas qasje direkte. Osht marre, turp është! Leni mo keto sene. Kunder, jom edhe kunder kom me kon saher tka ksi zhvillime ne Deqan, Edhe njerëz që si nuk i njeh kurkush ne opinion. Se lejon si profesionist. Ka njerëz ki-- prej shoqërive civile, prej njerëzve, prej qytetarëve. Merni vëlla qitni me veterana, a invalida, rritjani dikuje rrogë. Mos kqyrni dikon prej qituhit me 3 rroga a 4 veç pse oshtë e dera e zyrës s'kryetar. Turp është.

Hajdar Sutaj

Uhm, zotëri Demalijaj, kështu e parasheh ligji që mi pas 2 kuvendi dhe 1 ekzekutivi, sepse nëse i shkon mundesia për naj OJQ ose diçka. Uhm, sigurisht. Uhm, zonja Natyra Kuçi, propozuese PSD-së të ka fjalën. Nëse ki mundësi veç me prit mikrofonin, po.

Natyra Kuçi

Nëse folim për aspektin legal të këtij dokumenti, legalisht nën rregull, sepse normalisht që ekzekutivi propozon. Nëse folim për aspektin e zhvillimit kompanisë Hixhiena, adhurimi të këmbjes nuk besoj që oshtë emrin e duhun uhm, emrin propozu këto. Uhm, mirë po tu e dit çka sheh ben Hixhiena, qysh ka, uhm, shku çdo muj e tu u dobësu edhe ma shumë. Po dijet që emrat që janë të zgjedhur një emër për me ushtru kontroll mbi safin aty, mbi financat dhe mbi votimet. Kjo e dëshmon që po vazhdon qasja e njëjtë. E dimë që s'po përmendi emrat se po mvjen keq me përmend emrat që s'janë këtu. Mirëpo, sot kompania Hixhiena osht kompani e cila udhëheqet veç nga ni emër edhe ai është Bashkim Ramosaj. Po don me vazhdu kështu edhe edhe duke quajtur Manjollën aty si shef të kabinetit, si e ka ni prej njerëzve uhm ma të afërt. Po flasim në aspektin politik uhm për arsye sepse është shefe e kabinetit dhe uhm nuk kam pa Manjollën që ka naj afinitet për kompanit Pastrimit me zhvillu ose najherë që e ka ngrit zonin për këtë çështje. Po jo veç Manjolla, po as edhe njerëz tjere që tash

janë udhëheqje, nuk kanë kur vaj planin strategjik qysh munet Hixhiena me dal prej borxheve dhe qysh munet mu rimekemb edhe mu kthynë ni kompani që për mu dorën zemër ka qenë pi kompanive ma të mira që u që osht udhëheq nën kabinetin e uhm, zotit Ramosaj. Pra, jam kundër për këto arsye.

Hajdar Sutaj

Aaa, kryetari i komunës Bashkim Ramosaj e ka kërku fjalën.

Bashkim Ramosaj - Kryetari

Unë nuk jom tip që paragjykoj kon. As nuk e marrë guximin as vërtetë me gjyku unë dikon. Unë jam kryetar i komunës. Unë emeroj dikon, kon unë e vlerësoj. Kur boheni najher kryetar komune ju qe s'keni me pas atë fat. Ateher ju e emëroni kënd doni.

Hajdar Sutaj

Ë, falemnderit, falënderit shumë kryetar Adriatik Alaj, është lajmru për fjalë. Nëse ka mundësi regjia për me dhez mikrofonin

00:13:01,946 --> 00:13:21,756 [speaker_9]

Pershendetje z. Kryetar, pershendetje Kryesues, Drejtrr, kolege, Asambleist Gjith. Sa i përket kti komisioni, ëm une kisha thonë, nuk o mirë me paragjyku. Është dita e parë sot, sa, sapo ja kemi fillu punës. Le t'hijmë ta provojmë, ta shofim, t'ia lojmë kohës. Mos paragjykojmë edhe, e presim rezultatin nfund.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë. E qesim n votim, ë,. Po mfal se nuk t'pash qe je lajmru për fjalë. Ë, Shefja e Grupit LDK, zonja Hyri Dobrunaj, edhe ju kisha lutur ta dëgjojmë fjalën e saj.

Hyri Dobrunaj

Njejt të mendoj edhe për themelimin e këtij komisioni. Nuk e di a ka pasë ngutë. Në aspektin legal, mundemë thonë, jemi në rregull. Mirepo ne qofte se materiali nuk vjen përpara, për me mujt me lexue, Pakten, atëhere nuk eshte në rregull, po ne kemi të njejtën mendim që kemi pasë kur oshtë themeluar para 3-4 vite. Ëëë, ligji nuk e saktson, kur thotë... Dua anëtarët e Kuvendit, nuk e sakson opozitë, pa opozitë, sikur të kish pasur vullnet për n'funksionu mirë kjo ndërmarrje, atëhere kishin zgjedh normal edhe prej opozitës, njëherë i kalu me veç kemi qenë tu me qenë pjesë e ndihmës edhe e monitorimit. Se qat punë e kemi. S'e keni leju kështu që tash mundni ju prap me votu me bo çka doni. Na nuk e mbështetim dhe edhe nuk e votojmë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit. A ka dikush tjetër? Diskutim. Ok, qas votim. Adriatik Alaj, Kaltrina Ferizaj dhe Manjolla Shala. Kush është për? A ka kundër? A ka abstinim? Ju, atëherë me 11 vota për edhe me 9 vota kundër, është zgjedh Komisioni i Ri i Aksionerëve në përbërje të zotit Adriatik Alaj, zonjës Kaltrina Ferizaj dhe zonjës Manjolla Shala, të cilit i uroj pune t marë edhe suksese. Të nderuar koleg, kem kalu tek pika 11, që është te ndryshmet dhe gjithsecilli prej juve mundet mi ngrit temat edhe shqetësimet që ju e vlerësoni edhe ashtu mundemi bo pyetje kryetarit... Ën lidhje me ato te cilat mundemi pas shqetsimi, fillimisht është lejmru për fjalë z. Ndriqim Qekaj, të cilit i metëm në obligim edhe ma herët. Pastaj po po, po e renditmi.

Ndriqim Çekaj

Atëherë, falemnderit. Ë... Kjo temë që po e ngrej, s'ka të bëjë me, pikërisht me ndërmarrjen Hixhiena. Në kohët e fundit ka ndodhur ni punësim në këtë Hixhienë, dhe kam disa dilema në lidhje me këtë proces punësimi që ka ndodhur. Ë, pra, konkursin për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit në ndërmarrjen publike, i hapur me datën 25.09.2025, në pikën e Fushatës Zgjedhore, ndërsa me datën 14.01.2026 është publiku përfundimi i kësaj procedure, emrat e të punësurve: 4 anëtarë. Më shumë sesa me emra, problemin e kom me procesin. Procesi i rekrutimit është udhëheq prej Komisionit të Aksionarëve, i cili zgjidhet nga Asambleja. Po veç sa e zgjedhim komisionin ri? E zgjodhi Asambleja, ndërsa procesi është filluar edhe përfunduar në kohën kur mandati e Kuvendit... Që e ka zgjidhë këtë komision, ka qenë i përfunduar. Personalisht, kam dilema të mëdhana se ky proces është i ligjshëm edhe legitim. Zoti kryetar, si e shihni këtë proces? Në vlerësimin e juaj, a ka... a esht procesi ligjshëm? Sepse besoj që komisioni që i ka përfunduar mandatin, nuk besoj që ka drejtë në udhëheqëse të rekrutimit. Komisioni që u miratua tani, besoj që do jetë puna e parë e tij do të është anulimi i atij vendimi. Tani emrat që janë përzgjedhë, është tjetër temë, mundemi diskutu, por fillimisht për çështje të ligjshmërisë.

Hajdar Sutaj

Z. Qekaj, falemnderit, kryetarit ia kalojme fjalën
Kryetar, vazhdo.

Bashkim Ramosaj - Kryetari

Unë jom, tepër i bindun që jem me... Në suaza ligjore jemi në rregull, oshtë shkak se... Egziston në parim. Në komision që e themelon Ekzekutivi bashkë me Kuvendin, ka mandat derisa nuk merret në vendim tjetër. E për hir të së vërtetës, ne kemi pasë në telash me... Bordin, menaxhues, ku i kemi zgjat afatin kohor, ëh, dhe ky afat kohor ka kalu, është hap procedura, edhe oshtë përmbyll procedura, për zgjedhjen e katër anëtarëve të këtij bordi e ku ka metë edhe në procedurë e pa përfundum, që këta anëtarë të Bordit kanë me hapë në konkurs që me zgjedh, ëh, drejtori i këtij bordi që është edhe menaxhuesi, menaxhuesi i këtij bordi. Ëh, janë kompetenca që... E tjera të Komisionit të Aksionarëve që normal e kanë kontrollin ndaj Bordit, jo ndaj ndërmarrjes. Nuk ka drejtë, me shku me marrë npytje ndërmarrjen, kompaninë, punetoret a sene, mirpo krejt objektiva që ne dojmë me arritë, e si pronar të asaj ndërmarrjeje, e bojmë nëpërmjet Komisionit të Aksionarëve, që le... E ka mandatin deri te... Te Bordi, po ashtu edhe te raportimit ndërhyrja, te mbrojtja interesave e... Ëh... Themeluesit të këtij institucioni.

Hajdar Sutaj

Ëëë, falemnderit shumë. E kemi me. E kuart e kuart për tjetër pik. Përbes ngom se ju hi n'hak dhe kolegëve, Sylë Balaj, Vatan Istrefaj, Sylë Balaj e ka fjalën

Sylë Balaj

Pershendetje për të gjithë. Por në këtë seancë kisha një propozim për komision për mërgatë, duhet të theksohet se nevoja e për krimin e një komisioni për mërgatë duhet të perbehet nga të gjitha forcat politike, shoqërore e civile, për të trajtuar seriozisht nevojat e mërgatës tonë. Qëllimi i këtij komisioni është i qartë të identifikojnë, të adresojnë dhe të trajtojnë në mënyrë serioze nevojat, kërkesat, kërkesat dhe problemet e mërgatës sonë përmes instrumenteve institucionale dhe me qasje të koordinuara. Ky Kuvend është edhe i Mërgatës. Është njerëzish që që qeshtëja e qytetarëve që jetojnë këtu duhet të jetë. Është koha të kalojmë nga qaja elektorale në qasjen e qeverisë. Sepse Decani nuk është i partive, Decani është i qytetarëve. Ka ardh koha që kjo lidhje të mos mbetet vetëm emocionale, por të shndërrohet në bashkëpunim konkret dhe të strukturuar. Andaj zotërohem publikisht ta marr përsipër këtë iniciativë, ta sill si projekt para Kuvendit Komunal dhe të bashkëkryenoj procesin që së bashku ta ndërtojmë dhe funksionalizojmë gjithë këtë komision. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Syle falemnderit shumë. Nëse ki mundësi këta ca e the edhe nëse ki naj plotësim me na u drejtua para datës 10-15 , që me e shti e me me me modifikuar pak më shumë

Vatan Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Falemnderit për fjalën kryesues. Atëherë pasi jem te pikat tndryshme duhet të ndërlidhet me disa tema që prekin çdo dit jeten e qytetarëve, pa pa dallim garanci atyre. Kryetar, siç e dini, mandatin e kalum në kemi pasur një kontratë për vendosjen e ndriçimit publik në komplet territorin e komunës së Decanit. Kontrata ka qenë me vlerë milionësh dhe ajo ka qenë funksionale deri në mujin gusht ose shtator të vitit kalum mos gaboj. A mundesh me na naj arsye kryetar pse kjo kontratë ka përfunduar me kohë, po nuk janë përfunduar gjitha rrugët dhe rrugicat me ndriçim publik, po siç janë në lokalitetin nga vijë ndër në shumicën e fshatrave në Decan. Nuk është pothuajse askund përfundime ndriçimi publik. Në 100% rasteve kemi 60% 70 80 e kshu me radhe. Është pyetje vazhdueshme që marr nga qytetarët, pasi që jeni hi dikun në një rrugë të caktuar është vendos ndriçimi publik. Në rrugën tjetër, jo. Në shembull konkret, pastaj kryetar ka qenë në një periudhë kur është bërë edhe kontrata për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave në territorin e komunës së Decanit. Edhe kjo kontratë me vlerë milionshe, ku intensiteti i saj kryetar është përdorur më së shumti nga ana juaj në kohën e fushatës. Derisa qytetarët ja paten nisur me fol edhe qelni dyert të oborrit që po vijnë komunat po ja shtron edhe oborrin. Mas zgjidhjeve ra intensiteti i kësaj pune. Unë di që kontrata është në një periudhë kohore prej tri vitesh. Por a keni një plan se ku duhet filloni tash pas zgjedhjeve pranë këtë vit 2026? Ato fshatra që keni filluar për ti sanuar probleme të rrugëve dhe rrugicave, a do të vazhdoni me radhë apo do të shkoni në pjesën ad hoc të fshatrave, siç e keni vazhduar edhe herët e kalume? Po ashtu, sa jemi tek asfalti i rrugëve. Mandatin e kaluam para 6-7 muaj te themi. Kam bota në kërkesë me shkrim drejtuar për shërbime publike Izet Zenunit. Për

sanimin e disa problemeve në qendër të fshatit Strellc i Eperm tek sheshi Ismet Ukaj, rruga kryesore aty që ndërlihet me rrugën tek shkolla fillore Bajram Curri, ka probleme me qarkullim për shkak të gropave të mëdha që janë krijuar aty dhe konfrontimi shumë i madh si nga ana nxenesve e ashtu edhe makinave. Dhe nganjëherë mund të themi kështu edhe mu shpreh bukalishtë. Makina duke u rrujtur që mos me ra n'gropa, ajo ka mundësi me bo aksident. Kështu që është temë, që mundesh mi intervenuesh ndoshta ma shpejtë në te me anë të kontratës që e ki për mirembajtje. Po ashtu, pasi që jem në seancën e rregullt të parë të kësaj legjislature, e shoh të arsyeshme që ti falënderoj të gjithë qytetarëve që na kanë besuar në që sot të jemi përfaqësues të tyre. Për mua kjo është një përgjegjësi e madhe, pasi që duhet të jem përfaqësues i qytetarëve në çdo kohë dhe rrethanë të ndryshme. Gjithashtu vlerësoj se grupi parlamentar LDK-s do të jetë në funksion të qytetarëve dhe do të shërbejë atij si p.sh. Në fushat për transparente komunale, drejtësi dhe vendimmarrje. Po ashtu, do të jem i hapur për bashkëpunim me ekzekutivin komunal për gjitha punët e mira që do të bëhen në komunitetin tonë, por edhe i vendosur gjithashtu për të kundërshtuar çdo veprim apo për të qe e cenon drejtë përdrejtë në interesin publik. Faleminderit shumë!

Hajdar Sutaj

Faleminderit, zotëri Istrefi, kryetar. Do m'u përgjigj fillimisht. Po, a don ashtu. E e. E nderume. Ardiani ka qenë nrend para juve, zotëri. Binakaj, nëse jeni dakort të më respekthu rendin, po zoti Ardian Binakaj nga LDK-ja.

Ardian Binakaj

Përshëndetje edhe niherë. Adresimi që do ta bëj tani nuk ka të bëjë me punën që vuam vazhdimësi. Ma shumë ka të bëjë me imazhin e institucionit të Kuvendit Komunal. Në lidhje me këtë temë na kem pasur disa bëllafacime gjatë fushatë zgjedhore. Pikërisht une edhe ju, z. Sutaj. Anda ju kisha ftuar që të bëni kujdes ma shumë te tabela informuese. Ka prap gabimet drejtëshmimore. Në vend të anëtarësh të shkruar anëtar një ë mungon ktu anët edhe vazhdojmë tutje. Shpresoj që ta trajtoni si gabim teknik. Ta përmirësoni. Mos të kthehet në shantazh publik kjo punë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Kjo vërtetë është për sekretarinë edhe ju kam thanë. Me i rregullu përbes se kom kqyr. Po megjithatë i merrni edhe i rregulloni. I ktheni krejt çka ka gabime. Ti boni persdyti n'rregull. Faleminderit shumë. E e nderume Hyrije Dobruna e nderume shefja e grupit. E ka fjalën LDK-s.

Hyrije Dobrunaj

Asambleiste, për momentin edhe në këtë seancën e parë konstitutive unë kam vetëm një kërkesë prej qytetarëve të Deçanit.

Qyteti i Deçanit ka nevojë për një shtëpi të komunitetit. Shtëpi në të cilën do të mbahen ceremonitë, mbretërore, takimet, gjitha natyreve. Sepse për momentin qyteti i Deçanit nuk e ka një të tillë. Shtëpi për komunitetin që është shumë e nevojshme. Pastaj e kam edhe një kërkesë me bo ni pyetje këtu. Nashta nuk e di sa është, por këtu kam dasht te Izeti, te drejtori i Shërbimeve Publike. Eee, Dikush e ka prishur një shtyllë elektrike atje diku nga rrethi te Isniqi që menjëher si tkalon e para ose e dyta. Edhe njerëz aty që punojnë jon anku që s'e keni ndrru, ose nuk osht kompensu. Unë e di që praktikisht unë personalisht e kam prishur një çështje, por do të dasht me e paguar dhe osht ndërru ajo. Pse s'osht ndrru kjo këtu dhe kur do ni me e ndrru?

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Po, kryetar, për zonjën Hyrije Dobrunaj. Nashta të kanë njoftu kolegët që të kanë emru shefe t'grupit

Ah, okej, faleminderit. Kryetar, ah, se kryetar e ka një takim në orën 13:00, po nese ka mundesi me u pergjigj ne keto qe I ngriten si shqetesime

Bashkim Ramosaj - Kryetari

Po, po flasim për ndriçimin, ndriçimin publik. Eh, përtej asaj që ja tha kolega, ekziston edhe një fakt që, e ka shtylla që e kanë kablën e vnum, po nuk e kanë k'tu poqat. Ka vende ku i kanë poqat, po nuk e kanë kablën. E ka qenë mungesë e mjeteve në stok, që kompania ka pasur për obligim për mi vendos. E kupton e drejtë, nganjëherë fuqia e blerës nuk osht ajo që ne e imagjinojmë. Fuqia e blerës osht ajo që e kemi konkretisht, e ky, ky projekt ka me vazhduar, sepse ka qenë engazhim i përbashkët i gjithë neve që me pas ndriçim publik me krejt lagjet, e vendbanimeve të komunës së Deçanit. Sa i përket asfaltimit, eh, janë njëherë njerëz duhet me pas njezar zotesi që, kanë thone pleqt qysh kofsha, vofsha. Me këtë kuptim, aty ku osht shtru asfalt, e aty ku

osht punu, unë nuk kam shku si politik. Osht, nuk mundet me gjet askush ni rast të veçantë, që unë kam kërku naj favor kundrejt ni pune që e kryen institucioni komunal. Nuk ka me ndodh kjo, nuk ka ndodh kurrë, dhe nuk ka me ndodh. E kemi pas munds me operu, brenda mundësive tona buxhetore, për aq kilometra rrugë që janë të asfaltume, dhe për aq kilometra rrugë që janë të hapne e te mbulume me zhavor, që po pritët nga muji mars e tutje. E kur edhe ku osht ma përshendet me vazhdu me përmbyll ky projekt, i cili osht tradicional. Te, te e qendra ose te sheshi I heroit Ismet Uka. Ndoshta është e nevojshme me intervenu ma shpejt. E mirëpo osht afër rruga dej afër qendrës së Strellsit, ku në, krejt po, ne këtë, ne këtë far trajtimin, e kësaj traseje rrugore osht i përfshirë edhe, edhe sheshi. Në rast se osht naj punë urgjente se nuk e, nuk e pata parasysh, përcjellim problem saksisht. Eh, e, e prezantut, atëherë që osht diçka që nuk pret osht mirë me, me interviniu, sepse kemi, e kemi atë mundësi. Të, e pyetja koleges për shtëpinë e komunitetit, e nuk, nuk e kom mendu naj herë. Nuk e kom has si kërkesë naj herë. Uh, nuk di çka me thonë për momentin për shkak se, Deçani ka më shumë se katër vende ku po takohen, që janë të lagjev, me siguri nuk janë të krejt qytetit, po janë të lagjev. Uh, edhe po ashtu, Deçani ka, ka disa përparsi me me, me zona tjera, me komunitete tjera për shkak se mundet me i shfrytëzu edhe, uh, hapësira të institucioneve publike, qoftë të komunës, qoftë të pallatit, qoftë të qendrës rinore, të ekonomistë, artistëve et kështu më rradhë. Uh, e pata përshtypjen që po kërkohet diçka tjetër, po ma, ma vonë kur e sqarova edhe kuptova. E sa i përket shtyllave elektrike, shpesh kom bo pyetje edhe te Drejtoria e Shërbimeve edhe te Policia. Për shkak se njerëz kur po tekalojnë shpejtesine, ne kemi pas, nashta, nuk po e tham saksisht, po ma shumë se pesëdhjetë shtylla që janë të ndriçimit publik, në rrugën prej Agonisit e deri te, Tel Busha, janë thy këto shtylla, u dasht me i ndrru, shpesh herë i me met pa, pa ndriçim naj pjesë, qysh janë segmentet e ndame. Edhe m'ka interesu a jepet naj gjobë, për këta që i prishin këto shtylla. Edhe e keni pa nje fenomen në Deçan, i kem dy kaseta në trotuar. Sidomos bin sy prej mullinit e tGjikollve te poshtë. U bon që 6 vjet, që ne insistojmë, për mu ndrru këto kaseta. Dhe që është jonë obligim i KEDS-it, dhe kemi shumë telashe që të operojme, une jam falenderus për krejt ata që e kanë bo. Mirëpo që janë e neglizhues në këto, në këto tema jane. Që nganiherë na u ka dasht edhe me ndërhy edhe me dalë edhe para. Nashta mu morën pyetje pse kemi hek shtyllë kur u punu naj rrugë Se nuk e kan pas gat, gatishmërinë. Ashtu siç e tha zoti Sutaj, uh, unë me krejt respekt, kerkoj falje e se e kom ni takim në orën një, që e kom të pashmangshme.

Hajdar Sutaj

Falemnderit, kryetar! Dikush tjetër? Po, Adriatik Alaj.

Adriatik Alaj

Kryesues, masi ke fjalat e Shtëpia Kultures ne fshatin Drenofc, e kem një shtëpi te kulturs. E kem financim prej Ministrisë së Kulturës tash e gjashtë vite. Punet e vrazhda thuajse jane kryme 80-90 përqind janë të kryme. Ajo për momentin, Ministria e ka lon qashtu, prej se ka ndrru qeveria, ne zgjedhjet nacionale nuk o marë me atë punë. Ish kon mirë me ndërhy bile spaku, mia, mia dal ni pjesë për kulum ose për diçka. Mos më shku dam sepse krejt ai investim o tuj shku posht. Këtë këqijë çka mujm bojmë nkuader me Ministrinë e, mos me lon ashtu.

Bashkim Ramosaj - Kryetari

Kemi tri telashe të njëjtës natyre. E kem fushën sportive në Shaptej. E kem fushën sportive që osht met e plotë ne fshatin Izniq., Fatkikisht si kodet buxhetor janë shumë të shumta. Ministria e Kulturës e kemi bo një kërkesë. Kemi bo lobim që me u ri-inicu procedura dhe po ashtu kemi marr përsipër si kuvend, që në rast se nuk kemi arrit, nuk kemi arrit për me bo këtë pjesë. Atëherë obligim ka me i mbete komunës, sepse --- .

Hajdar Sutaj

Falemnderit, kryetar. Dikush tjetër? S'ka. Me kaq e shpalli te mbyllur kete takim. Mirë, u takofshmi në mbledhjet e radhës.